



USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 50 (827748)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 10 Dhjetor 2021

Rreziku nga sulmet kibernetike



Peleshi: Qeveria do të subvencionojë studimet në këtë fushë, bonuse për specialistët e mbrojtjes kibernetike në shtet

Siguria kibernetike po bëhet çdo ditë e më shumë një fushë që kërkon fuqi punëtore të specializuar, ndaj ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, si drejtues i institucionit që shumë shpejt do të marrë drejtimin për garantimin e mbrojtjes kibernetike, përshëndeti pjesëmarrësit në aktivitetin inovativ "Cyber Camp

Albania", ku ftoi të rinjtë të orientojnë karrierën e tyre drejt kësaj fushe. Ministri Peleshi vuri në dukje rrezikun që u kanoset shpesh institucioneve shtetërore dhe jo shtetërore nga sulmet kibernetike, jo vetëm në Shqipëri, por në SHBA, ku, siç tha ai, në çdo 39 sekonda ka një sulm të tillë. Shembuj... >>> faqe 2

Roli i Lidershit të Lartë Ushtarak Shqiptar në Krijimin e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare



>>> faqe 6-7

109-vjetori i Forcave të Armatosura Peleshi: Mirënjohje për ushtarakët që e krijuan dhe i dhanë jetë kësaj force moderne

Gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj: Nderim dhe mirënjohje ndaj themeluesve dhe arkitektëve të forcës ushtarake të vendit dhe të gjithë gjeneratave që kanë shërbyer e kontribuar në vite >>> faqe 3



Vizita/ USEUCOM&USAREUR

Gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj: Defender Europe-21 ishte shembulli më i mirë i këtij bashkëpunimi

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj zhvilloi një vizitë zyrtare në Komandën Amerikane në Evropë (USEUCOM) dhe atë të Ushtrisë Amerikane për Evropën dhe Afrikën (USAREUR), në Shtutgard dhe Viesbaden, Gjermani. Pjesë e delegacionit ishte edhe ambasadorja amerikane në Tiranë Juri Kim, atasheu ushtarak i Mbrojtjes së SHBA-së, kapiten i Rangut të II-të...



>>> faqe 4

Ceremonia e certifikimit të nënoficerit

Gjeneral brigade Ylli Pulaj: Përfshirja e nënoficerit në nivelet drejtuese për të ecur krah për krah me oficerët dhe personelin civil

Në Komandën e Forcës Ajrore, u zhvillua ceremonia e certifikimit të nënoficerit më të mirë të vitit 2021 të Forcës Ajrore. Në aktivitet ishin të pranishëm zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, shefi i shtabit kolonel Arben Cenolli, kryekapiteri i shefit të Shtabit të Përgjithshëm Albert Koka, nënoficerët e Forcës si dhe shefa e ushtarakë nga shtabi e komanda e Forcës Ajrore. Nënoficeri... >>> faqe 5



Të sigurohemi që zërat e grave të dëgjojnë

Mircea Geoana: Koncepti ynë i ardhshëm strategjik nuk do të jetë i verbër ndaj gjinisë

>>> faqe 8

26 SHEFAT E SHTABIT TË PËRGJITHSHËM

Krenaria e kombit shqiptar feston 109-vjetorin e krijimit të saj

faqe 10-11

BOTIMI

Sfetigradi (Fundi i një enigme)

faqe 12

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Begaj, mori pjesë në takimin virtual të Komitetit Ushtarak të NATO-s, në nivel Shefash Shtabi të Përgjithshëm.

Shefat e Mbrojtjes të vendeve të Aleancës u mblodhën për të diskutuar mbi sfidat e sigurisë me të cilat po përballon Aleanca, në të gjitha fushat operationale dhe zonat gjeografike të përgjegjësisë. Gjithashtu, qëllim i këtij takimi ishte edhe promovimi i transparencës midis aleatëve dhe koordinimi i aktiviteteve të vazhdueshme kombëtare me ato të Aleancës.

Komandanti Suprem i Aleatëve në Europë (SACEUR) dhe Ndihmës Sekretari i Përgjithshëm për Inteligjencën dhe Sigurinë, informuan dhe përditësuan Komitetin Ushtarak. Ndërkohë nga shefat e Mbrojtjes u shkëmbyen mendime dhe informacione, duke nënvizuar rëndësinë që ka mirëkuptimi kolektiv në parandalimin, frenimin dhe qëndrimin mbrojtës të Aleancës.

Gjeneralmajor Begaj, në fjalën e tij shprehu falënderimin për thirrjen e këtij takimi, me qëllim për t'u informuar dhe diskutuar për çështjet

Gjeneralmajor, Prof. Asoc. Bajram Begaj, merr pjesë në Takimin virtual të Komitetit Ushtarak të NATO-s

GJENERALMAJOR BEGAJ: Angazhimi ynë për ndjekjen e situatës së shkaktuar nga dislokimet dhe aktiviteti rus në kufirin me Ukrainën, por edhe në kufirin me vendet e NATO-s në Ballkanin Perëndimor, do të ketë interesin e duhur



më urgjente të situatës së sigurisë jo vetëm në Lindje, por edhe në krahun jugor, veçanërisht në Ballkanin Perëndimor. Ai falënderoi SACEUR për përditësimin dhe vlerësimin operacional të situatës së sigurisë në zonën e përgjegjësisë së NATO-s, si dhe theksoi mbështetjen e plotë për këtë vlerësim gjithëpërfshirës. Gjithashtu, gjeneralmajor Begaj shprehu angazhimin për ndjekjen me shumë interes të situatës së shkaktuar nga dislokimet dhe aktiviteti rus në kufirin me Ukrainën, por edhe në kufirin me vendet e NATO-s në Ballkanin Perëndimor. Komiteti Ushtarak, i kryesuar nga admiral Rob Bauer, është përgjegjës për këshillimin e autoriteteve politike të NATO-s mbi masat që konsiderohen të nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen e përbashkët të territorit të NATO-s, si dhe për zbatimin e vendimeve në lidhje me operacionet dhe misionet e NATO-s.

Rreziku nga sulmet kibernetike

Siguria kibernetike po bëhet çdo ditë e më shumë një fushë që kërkon fuqi punëtore të specializuar, ndaj ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, si drejtues i institucionit që shumë shpejt do të marrë drejtimin për garantimin e mbrojtjes kibernetike, përshëndeti pjesëmarrësit në aktivitetin inovativ “Cyber Camp Albania”, ku ftoi të rinjtë të orientojnë karrierën e tyre drejt kësaj fushe.

Ministri Peleshi vuri në dukje rrezikun që u kanoset shpesh institucioneve shtetërore dhe jo shtetërore nga sulmet kibernetike, jo vetëm në Shqipëri, por në SHBA, ku, siç tha ai, në çdo 39 sekonda ka një sulm të tillë. Shembuj ka edhe për ndërhyrjen përmes këtyre sulmeve në procese elektorale, apo në infrastrukturën kritike të shteteve.

Duke sjellë edhe përvojën e Izraelit, ku ministri Peleshi ishte për vizitë zyrtare pak ditë më parë u shpreh: “Kjo do të thotë që ka nevojë për talente, ka nevojë për fuqi punëtore, për njerëz të kualifikuar. Sot në botë ka miliona vende pune bosh në fushën e zhvillimit të software-ve dhe aq më tepër në fushën e Mbrojtjes Kibernetike. Unë isha para disa ditësh në Izrael e, vetëm në Tel Aviv kishte 17 mijë vende pune, të cilat nuk mbusheshin dot, sepse nuk i gjenin dot në treg. Janë miliona vende pune në botë, të cilat presin talente dhe për këtë arsye këto fusha janë nga fushat më të paguara, profesionet më të paguara”. Sipas z. Peleshi, Ministria e Mbrojtjes do të punojë bashkë me Agjencinë e Certifikimit Elektronik të Mbrojtjes Kibernetike për të bërë politikën e mbrojtjes kibernetike, standardet, rregullat e zbatueshme nga të gjitha ato institucione të cilat janë pjesë e infrastrukturës kritike që domosdoshmërisht duhet të kenë të zhvilluara kapacitetet e mbrojtjes kibernetike. Ai tha se gjithçka fillon nga edukimi dhe sot janë 16 studentë që fillojnë Mas-

Peleshi: Qeveria do të subvencionojë studimet në këtë fushë, bonuse për specialistët e mbrojtjes kibernetike në shtet

Ministri i Mbrojtjes: Krahas bachelorit në sistemin e arsimit privat apo shtetëror do të shtojmë një program të posaçëm qeveritar, edukimin dhe trajnimin e shpejtë në fushat ku rreziku nga sulmet kibernetike është i madh: kodim, programim, mbrojtje



terin e Mbrojtjes Kibernetike pranë Akademisë së FA-së, ndërsa po punohet për të shtuar mundësitë e kualifikimeve, trajnimeve në këtë fushë.

“Kështu që krahas bachelorit në

sistemin e arsimit privat, apo shtetëror do të shtojmë dhe do të mbështesim, do të subvencionojmë me një program të posaçëm qeveritar edukimin dhe trajnimin e shpejtë në fushat për të

cilat po flasim pra: kodim, programim, mbrojtje kibernetike. Mundësitë janë të jashtëzakonshme. Ne kemi një fond për mbështetjen e njëmijë apo dymijë koduesve, ose të rinjve, që duan të

kualifikohen dhe të bëhen kodues, apo të punojnë në të gjitha fushat e IT, këto si subvencion, pra për të paguar bursat e tyre. Kemi disa kompani shumë të mira që janë në kontakt me qeverinë dhe do të jenë aplikues të këtij fondi”, - u shpreh ministri Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes u shpreh se kryeministri ka dhënë dritën jeshile për të shtuar pagesën me bonuse për specialistët e kësaj fushe në administratën shtetërore, duke i barazuar këto paga me tregun privat.

Aktiviteti inovativ “Cyber Camp Albania” është konceptuar si një aktivitet vjetor, i cili do të organizohet me dy edicione (dhjetor dhe maj) të çdo viti akademik, për të theksuar rëndësinë e edukimit dhe orientimit drejt profileve të sigurisë kibernetike të të rinjve në fazat e hershme të studimit në njërin anë dhe ngritja e kapaciteteve të profesionistëve që punojnë në fushën e sigurisë kibernetike dhe kimit kibernetik në nivel kombëtar në anën tjetër.

109-vjetori i Forcave të Armatosura

Peleshi: Mirënjohje për ushtarakët që e krijuan dhe i dhanë jetë kësaj force moderne

Sot përkrah NATO, aleancës më të madhe politike dhe ushtarake në botë

Ministri Peleshi: 4 dhjetori shënon 109-vjetorin e krijimit të ushtrisë shqiptare. Më 4 dhjetor 1912, 6 ditë pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë u krijua Ushtria Kombëtare dhe për herë të parë u krijua dhe Ministria e Mbrojtjes Kombëtare, ku Forcat e Armatosura u ndanë në Forca Tokësor, Forca Detare dhe Forca Ajrore. Në rrugëtimin e tyre një shekullor kanë hasur vështirësi, të cilat i kanë kaluar me sukses siç dinë veç djemtë dhe vajzat nën uniformën ushtarake.

Krenar sot të jem mes jush si një forcë moderne, profesionale dhe e arsimuar njëlloj si koleget tuaj të NATO-s, aleancës më të madhe politike dhe ushtarake në botë. Mirënjohje për ushtarakët që e krijuan dhe i dhanë jetë kësaj force moderne.



Mesazh urimi i SHSHPFA me rastin e 109-Vjetorit të Krijimit të Forcave të Armatosura

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, me anë të një mesazhi, ka uruar ushtarë, nënoficerë, oficerë dhe civilë të Forcave të Armatosura, me rastin e 109-vjetorit të krijimit të tyre:

Të nderuar ushtarakë dhe civilë të Forcave të Armatosura, si Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, kam kënaqësinë t'ju përshëndes dhe t'ju uroj për përvjetorin e 109-të të Krijimit të Forcave tona të Armatosura!

4 Dhjetori i vitit 1912 është një kushtim i të parëve tanë ndaj kujtesës kombëtare për vlerën dhe rëndësinë e Forcave të Armatosura, por edhe tribuna për të shprehur nderimin dhe mirënjohjen tonë ndaj themeluesve dhe arkitektëve të forcës ushtarake të vendit dhe të gjithë gjeneratave që kanë shërbyer e kontribuar në vite. Kjo ditë është momenti që të ndjehemi krenarë për rrugëtimin e lavdishëm dhe për statusin e nderuar e të vlerësuar që kemi fituar brenda shoqërisë tonë, por edhe midis aleatëve tanë në Aleancën Euroatlantike.

Forcat e Armatosura janë sot nderi dhe krenaria e vendit, në sajë të angazhimeve dhe kontributeve të qenësishme dhe të rëndësishme në misionet brenda vendit dhe ato ndërkombëtare. Ky është një motiv i mjaftueshëm që t'u shpreh një mirënjohje dhe respekt të veçantë të gjithë atyre që kanë kontribuar në vite dhe atyre që janë aktualisht të angazhuar në vijën eparë të frontit të Aleancës dhe organizmave të tjerë ndërkombëtar në Letoni,

Gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj: Nderim dhe mirënjohje ndaj themeluesve dhe arkitektëve të forcës ushtarake të vendit dhe të gjithë gjeneratave që kanë shërbyer e kontribuar në vite



Kosovë, Bosnjë-Hercegovinë e Sudan. Sot, për të gjithë ne njerëzit me uniformë, është gjithashtu çasti solemn, t'u kushtojmë një përlujë dhe homazh të veçantë të gjithë atyre që me vetëmohim kanë bërë edhe sakrificën sublime në shërbim të Shqipërisë brenda dhe jashtë vendit. Respekt dhe mirënjohje edhe për gjithë familjet e ushtarakëve, që me përfshirjen dhe mbështetjen e tyre të pakushtëzuar dhe të pakursyer, janë bërë pjesë e pandarë e kontributeve dhe komunitetit tonë ushtarak.

Me shërbimin dhe kontributin e saj në çdo situatë nevojë dhe emergjence të komunitetit e qytetarëve, në çdo skaj të vendit, Forcat e Armatosura janë bërë një pjesë integrale, e dashur dhe e kërkuar e gjithë shoqërisë tonë. Ky angazhim, do të vazhdojë të ngelet prioriteti dhe detyrimi ynë më i rëndësishëm.

Të nderuar ushtarë, nënoficerë, oficerë dhe civilë të Forcave të Armatosura, ky përvjetor i gjen Forcat tona të Armatosura me mesazhe të rëndësishme për një vëmendje

të shtuar përkujdesjeje, për një mbështetje dhe motivim të merituar dhe rritje të dinjitetit të të gjithë personelit që shërben dhe ka shërbyer në Forcat e Armatosura, por edhe për një modernizim, zhvillim dhe rritje të aftësive të tyre.

Kam bindjen time të palëkundur se me angazhimet dhe përkushtimin tonë, kurdoherë do ta meritojmë plotësisht dhe denjësisht respektin dhe besimin e popullit, të autoriteteve të vendit dhe të aleatëve tanë në NATO. Është rasti i këtij përvjetori, t'i sigurojmë të gjithë, se devocioni i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të jetë gjithmonë atdheu, nderi, detyra dhe se ato do të jenë të suksesshme në përmbushjen e misionit të tyre fisnik.

Me mirënjohjen dhe respektin më të thellë për shërbimin, sakrificat dhe kontributin tuaj dinjitoz, ju uroj gëzuar këtë përvjetor të Forcave të Armatosura!

**Gjeneralmajor
Prof. Asoc. Bajram Begaj
Shefi i Shtabit të Përgjithshëm**

SHSHP të FA vizitë zyrtare USEUCOM dhe USAREUR

Gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj: Defender Europe-21 ishte shembulli më i mirë i këtij bashkëpunimi

Shqipëria, vend pritës për stërvitjen Resolute Castle për vitin 2022 dhe pjesë e Stërvitjeve Defender Europe 23/25

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj zhvilloi një vizitë zyrtare në Komandën Amerikane në Evropë (USEUCOM) dhe atë të Ushtrisë Amerikane për Evropën dhe Afrikën (USAREUR), në Shtutgard dhe Viesbaden, Gjermani. Pjesë e delegacionit ishte edhe ambasadorja amerikane në Tiranë Juri Kim, atasheu ushtarak i Mbrojtjes së SHBA-së, kapiten i Rangut të II-të David Millner, Shefi i zyrës Amerikane Bashkëpunimit të mbrojtjes N/Kolonel Erol Munir.

Gjeneralmajor Begaj u prit në takim nga komandanti i USAREUR gjeneral Christopher G. Cavoli si dhe zëvendëskomandanti i EUCOM gjeneraljejtënant Michael L. Howard. Në fjalën e rastit gjeneralmajor Begaj theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ushtarak që ekziston midis Shqipërisë dhe SHBA-së, duke vlerësuar kontributin e vazhdueshëm që ushtria amerikane ka dhënë dhe vazhdon të japë në rritjen e aftësive operacionale të FARSH.

Nga ana e tyre, gjeneral Cavoli dhe gjeneraljejtënant Howard vlerësuan maksimalisht angazhimin dhe performancën e treguar nga FARSH në të gjitha kontributet ndër vite, si pjesë e misioneve dhe operacioneve të ndryshme, qoftë kjo pjesë e NATO-s apo edhe ato me SHBA.

Gjatë bashkëbisedimit me të dy autoritetet, gjeneralmajor Begaj shprehu gatishmërinë dhe rëndësinë për vazhdimin e këtij bashkëpunimi, tashmë të konsoliduar dhe të suksesshëm. Veçanërisht vlerësoi mbështetjen që Departamenti i Mbrojtjes të SHBA-së planifikon të japë me këshilltarë nga Brigada e Ndihmës së Forcave të Sigurisë për trajnimin, këshillimin, dhe ndihmesën për b2k të FT-së, njësi e cila është planifikuar t'i nënshtrohet vlerësimit të aftësive të NATO-s për vitin 2022. Përveç asistencës teknike, u vlerësua edhe kontributi me pajisje moderne dhe bashkëkohore për këtë batalion, por edhe për njësitë e tjera të FARSH, si regjimenti i helikopterëve me helikopterët Black Hawk, repartet EOD, Qendra e Mbrojtjes Cyber, etj. Shqipëria dëshiron gjithashtu të ofrojë përdorimin e infrastrukturës ushtarake për stërvitje e trajnime të ndryshme për aleatin strategjik SHBA si dhe NATO. Defender Europe - 21 ishte shembulli më i mirë i këtij bashkëpunimi dhe Shqipëria do të jetë vend pritës për stërvitjen Resolute Castle për vitin 2022 dhe pjesë e Stërvitjeve Defender Europe 23/25.

Më tej, gjeneralmajor Begaj shprehu një falënderim të veçantë edhe për Zyrën e Bashkëpunimit të SHBA-së në fushën e Mbrojtjes të atashuar në Shqipëri, për punën e vazhdueshme që kjo strukturë vazhdon të japë në këtë drejtim.

Gjatë vizitës, gjeneralmajor Begaj zhvilloi takime edhe me drejtorët e Zbulimit, Planifikimit, Stërvitjeve dhe Operacioneve, si dhe atë të Partneritetit. Për këtë të fundit, nga



SHSHP të FA-së u akordua certifikata e mirënjohjes me motivacionin "Për mbështetjen e vazhdueshme dhe të gjithanshme ndaj Shqipërisë, duke rritur

ndjeshëm aftësitë e FARSH në fushat e EOD dhe menaxhimit të municioneve (PSSM), si dhe projektet e Ndihmës Humanitare ndaj popullsisë".

USEUCOM realizon një gamë të gjerë operacionesh, në koordinim me aleatët dhe partnerët për të mbështetur NATO-n, për të penguar Rusinë, për



të mundësuar operacione globale si dhe për t'iu kundërvënë kërcënimeve ndërkombëtare. Ndërkohë, USAREUR siguron forca tokësore të gatshme për të penguar, dhe nëse është e nevojshme, për të mposhtur çdo agresion nga kundërshtar të mundshëm në Evropë dhe Afrikë. Për ta arritur këtë, USAREUR është e përgatitur të shërbejë si shtab i Forcave të Përbashkëta, për të luftuar në të gjithë spektrin e plotë të operacioneve ushtarake, nga reagimi ndaj emergjencave apo krizave, dhe deri në luftime në shkallë të gjerë.

Përfundon Kursi i 71-të Fillestar i Nënoficerit në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve

Komandant Arben Toska: QAPN do të jetë gjithmonë e hapur për të mbështetur në çdo kohë trupën e nënoficerëve të FA-së

Në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve, u zhvillua ceremonia e certifikimit të Kursit të 71-të Fillestar.

Në këtë ceremoni morën pjesë Komandanti i QAPN-së, stafi i Komandantit, personel nga Dega e Administratës dhe Arsimit, si dhe stafi instruktorë dhe mësime të tjerë.

Gjatë ceremonisë përshëndetën Komandanti i QAPN-së, instruktori përgjegjës i kursit fillestar dhe kursanti i kursit fillestar të nënoficerit, i cili përfundoi kursin me rezultate të larta.

Në fjalën e tij përshëndetëse Komandanti i QAPN-së, Kolonel Arben Toska theksoi se "kjo ceremoni është tepër domethënëse, pasi përkon disa ditë pas festave tona kombëtare të 28-29 nëntorit, ditës së 109 vjetorit të krijimit të Forcave tona të Armatosura, e cila përbën një eveniment shumë të rëndësishëm dhe madhor jo vetëm për



ushtrinë tonë, por për gjithë popullin shqiptar".

QAPN do të jetë gjithmonë e hapur për të mbështetur në çdo kohë trupën e nënoficerëve të FA-së, për thellimin e mëtejshëm të njohurive që kanë marrë

në kurset e zhvilluara në këtë institucion, për rritjen e aftësive profesionale të tyre.

Në këtë ceremoni u certifikuan 52 kursantë. Në përfundim të kësaj ceremonie u zhvillua dhe një koktej

me pjesëmarrësit e ceremonisë dhe kursantët e kursit fillestar, ku u krijua një atmosferë e ngrohtë dhe festive nga stafi i QAPN-së, duke qenë se kjo ceremoni përkon në prag të festave të fund vitit.

Ceremonia e certifikimit të nënoficerit më të mirë të vitit 2021

Gjeneral brigade Ylli Pulaj: Përfshirja e nënoficerit në nivelet drejtuese për të ecur përpara krah për krah me oficerët dhe personelin civil

Në Komandën e Forcës Ajrore, u zhvillua ceremonia e certifikimit të nënoficerit më të mirë të vitit 2021 të Forcës Ajrore.

Në aktivitetet ishin të pranishëm zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, shefi i shtabit kolonel Arben Cenolli, kryekapteri i shefit të Shtabit të Përgjithshëm Albert Koka, nënoficerët e Forcës si dhe shefa e ushtarakë nga shtabi e komanda e Forcës Ajrore.

Nënoficeri i Forcës Ajrore kapter Aida Guxha në fjalën e hapjes falënderoi zëvendëskomandantin dhe drejtuesit e strukturave të Forcës Ajrore për mbështetjen e nënoficerëve në vijimësi gjatë kryerjes së detyrave dhe kontributit të tyre por edhe për mundësimin e kryerjes së procesit të përzgjedhjes së nënoficerit më të mirë të vitit nga Bordi i Vlerësimit të Nënoficerëve, i cili analizoi me seriozitet dosjet dhe vlerësoi me transparencë e meritë trupën e nënoficerëve duke përzgjedhur tre më të mirët në Forcën Ajrore, për të vijuar më tej konkurrimin për përzgjedhjen e nënoficerit më të mirë të vitit në rang FA.

Gjeneral brigade Ylli Pulaj në fjalën përshëndetëse vlerësoi rolin dhe kontributin e nënoficerit në Forcën Ajrore, duke theksuar rëndësinë e përfshirjes së nënoficerit në nivelet drejtuese si dhe domosdoshmërinë e vetëzhvillimit dhe përmirësimit të nënoficerit për të ecur përpara krah për krah me oficerët dhe personelin civil, për të merituar këtë rol që jep struktura ushtarake dhe realizuar së bashku objektivat e Forcës.

Në fund të ceremonisë u shpërndanë certifikata vlerësimi për 3 nënoficerët më të mirë të Forcës Ajrore për vitin 2021, respektivisht në vendin e parë rreshter Agron Greca, efektivi në



Gjeneral brigade Ylli Pulaj: Është shumë e rëndësishme përfshirja e nënoficerit në nivelet drejtuese si dhe domosdoshmëria e vetëzhvillimit dhe përmirësimit të nënoficerit, për të ecur përpara krah për krah me oficerët dhe personelin civil, për të merituar këtë rol që jep struktura ushtarake dhe realizuar së bashku objektivat e Forcës

Bazën Ajrore Farkë, në vendin e dytë tetar Ledion Vangjeli, efektivi në Bazën Ajrore Kuçovë dhe në vendin e tretë tetar Nesli Ormeni, efektivi në shtabin e Forcës

Ajrore Rinas.

Nënoficerëve u lind e drejta për të vazhduar garën për Nënoficerin më të mirë të vitit 2021 në Forcat e Armatosura.



IN MEMORIUM

Me trishtim të thellë mësuam për ndarjen e parakohshme nga jeta të Kapitenit të Rangut III, Bledar Kasneci. Forcat Detare humbën një prej njerëzve më të përkushtuar, miqtë një shok të mirë e të kudogjendur, të afërmit njeriun e dashur dhe babanë shembullor. Ngushëllime familjes dhe kolegëve! Boshllëku që la pas ikja e dhimbshme e Bledar Kasnecit, është sa njerëzor aq edhe profesional.



U zhvilluan me sukses “Ditët e Detarisë”, Vlorë

Nga Shefqet Kërçelli

U zhvilluan “Ditët e Detarisë shqiptare” në Pallatin e Kulturës Labëria, Vlorë, një aktivitet që ka për qëllim promovimin e vlerave të detarëve shqiptarë, veçanërisht atyre të trevës së Vlorës, në zhvillimin e transportit detar në vendin tonë që nga themelimi i shtetit shqiptar dhe aktualisht. Në këtë aktivitet të veçantë, që u zhvillua për herë të parë në Vlorë, morën pjesë detarë, veteranë të Flotës Tregtare, Luftarake, të Peshkimit nga Vlora dhe nga zona të tjera, familjarë të detarëve, pedagogë e studentë të Universitetit “Ismail Qemali”, dega navigacion, detarë të Flotiljes Detare Pashaliman, përfaqësues të pushtetit qendror e vendor të Vlorës, përfaqësues të institucioneve detare, të shoqatave atdhetare-kulturore Vlorë, përfaqësues të mediave, artistë vlonjatë që trajtojnë temën e detit, etj.

E veçantë e aktivitetit është se këto ditë të bekuara për detarinë shqiptare zhvillohen në kuadrin e ditës së flamurit, ku për herë të parë jepet me dokumente, kontributi i detarëve tanë në furnizimin me armë të luftëtarëve për pavarësi.

Në ceremoninë e hapjes morën pjesë dhjetëra detarë nga Durrësi,

Vlora e qytetet e tjera bregdetare.

Mbas ekzekutimit të himnit kombëtar, ceremoninë e hapi Kryetari i shoqatës “Detaria shqiptare”, dega Vlorë, zoti Dhionis Andoni, më pas përshëndeti kryetari i Bashkisë z. Dritan Leli, kryetari i Shoqatës Kombëtare Detare “Adrijon”, z. Aleksandër Gjermani dhe ish Komandanti i Flotës Tasim Mece.

Pjesë e këtij aktiviteti ishte dhe dhënia e certifikatave të mirënjohjes për kontribut të veçantë në Flotën Luftarake, Flotën Detare Tregtare dhe atë të Peshkimit, disa prej detarëve vlonjatë. Më pas pjesëmarrësit vizituan ekspozitën e detarisë shqiptare, e hapur për herë të parë në Vlorë. Ata u interesuan për çdo hap të zhvillimit të mjeteve dhe transportit detar dhe personazhet kryesore të zhvillimit të këtyre sektorëve jetikë në vendin tonë.

Të përmalluar e me lot në sy, detarët takoheshin dhe kujtonin punën, vështirësitë e sakrificat në lundrimet e gjata. Ndërkohë ata shprehën shqetësimin për zhvillimin e transportit detar dhe arsimimin e detarëve të rinj në të tashmen dhe të ardhmen.

Ditët e detarisë shqiptare vazhduan të qëndrojnë të hapura për disa ditë ku qytetarët e detarët vlonjatë, pavarësisht motit të keq, vizituan



me dëshirë ekspozitën.

Nga komisioni organizator vazhdoi pritja dhe shoqërimi i vizitorëve, bisedat, intervistat, fotot dhe vlerësimet në librin e përshtypjeve. Detarë dhe familjarë që kanë banuar në Sazan, që kanë shërbyer në Pashaliman apo në anijet tregtare e të peshkimit shkëmbyen mendime dhe lanë përshtypjet e tyre, duke e vlerësuar ekspozitën si një vlerë të shtuar për qytetin e Vlorës.

Me rastin e 109-vjetorit të themelimit të Ushtrisë Shqiptare u zhvillua seksioni përkujtimor-shkencor

Krijimi i Ushtrisë Kombëtare Shqiptare ndodhi pak ditë pas shpalljes së aktit historik të Pavarësisë së Shqipërisë dhe krijimit të shtetit të pavarur modern. Institucionet e Mbrojtjes dhe Ushtria Shqiptare e kanë zanafillën tek Pavarësia dhe shteti i pavarur shqiptar, ato kanë moshën e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Roli i lidershipit në këto institucione ishte i dukshëm dhe përcaktues në organizimin ushtarak dhe ngritjen e Ushtrisë Shqiptare.

Për të sjellë në vëmendjen e brezave historinë e formimit të këtij institucioni dhe lidershipet e tij, u zhvillua seksioni “Roli i Lidershipit të Lartë Ushtarak Shqiptar në Krijimin e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare”, me pjesëmarrjen e disa prej studiuesve tanë ushtarakë.

Fjalën e hapjes e mbajti z. Proletar Hasani, i cili theksin e tij e vuri mbi rolin e lidershipit të lartë ushtarak, në ngritjen, zhvillimin dhe drejtimin e institucioneve të mbrojtjes dhe të ushtrisë shqiptare.

Kumtues të tjerë, të cilët do trajtonin me detaje “Gjurmët e lidershipit ushtarak të lartë shqiptar”, ishin z. Asllan Zemani dhe z. Bashkim Qeli.

Bernard Zotaj dhe Zaho Golemi do na sillnin edhe njëherë në kujtesën tonë Ministrin e parë të Luftës, Mehmet Pashë Dërrallën, ndërsa z. Sali Onuzi, me dëshirën për të sjellë sa më pranë lexuesit emra historikë të cilët kanë shënuar suksese në veprimtaritë e tyre ushtarake, solli emrin e drejtuesit të Shtabit

Dr. Asllan Zemani

Tashmë nuk përbën më një fakt të ri njoftimi se historia e popullit shqiptar është e mbushur me luftëra për liri dhe pavarësi kundër pushtuesve të huaj. Duke qenë e tillë, kjo histori, sigurisht ka pasur protagonistët si dhe artin e saj luftarak, me të përbashkëtat dhe me veçoritë e veta dalluese nga ato të vendeve e të popujve të tjerë, në periudha të ndryshme të historisë së Shqipërisë.

Pikërisht për të pasqyruar dhe shpjeguar këto dukuri shërben Historia Ushtarake, e cila edhe në Shqipëri ka fillimin, ecurinë dhe zhvillimet e veta, gjithashtu në një proces me arritjet, mangësitë dhe veçoritë dalluese. Çështja nuk është se historia ushtarake është e palëvruar, përkundrazi, për të është shkruar jo pak, por sepse asnjë herë nuk është shkruar në mënyrë të sistemuar dhe se nuk ka, deri më sot, një pasqyrë të kronologjisë dhe të ecurisë së saj reale, tërësisht shkencore, në të gjitha pjesët dhe treguesit përbërës të saj.

Në historinë më se njëqind vjeçare të Ushtrisë Shqiptare roli i lidershipit ka qenë dhe është më i spikatur në Forcat e Armatosura pasi, ky rol me të drejtë konsiderohet si “frymëmarrja” e kësaj force, pra, është pikërisht ai që prodhon adrenalinën e cila ngre lart moralin e ushtarakut duke e çuar atë deri në vetë-sakrificim.

Gjithkush që ka shfletuar dhe lexuar kronikat apo shtypin e periudhës së pas vitit 1912, që ka shfletuar librat e

Roli i Lidershipit të Lartë Ushtarak Shqiptar në Krijimin e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare



Lidershipi shqiptar në vite



historisë dhe e njeh historinë ushtarake shqiptare, me siguri ka mësuar dhe e di mirë tashmë se, Shqipëria historikisht ka nxjerrë ushtarakë të shquar në të gjitha kohërat.

Shumë nga këta djem u bënë ushtarakë me grada dhe poste të larta, duke ndikuar me shërbimet, me punën dhe përkushtimin, me aftësitë dhe pasionin e pafund që i karakterizonte, për interesat e vendeve ku shërbyen. Kësaj, emrat e shumë oficerëve shqiptarë të asaj periudhe mbushin lista të gjata,

të shndërruara tashmë në dokumente arkivore, në ekspozate muzesh, si dhe janë bërë personazhe të shumë librave historikë. Për rrjedhojë ata janë bërë, njëherësh, edhe pjesë e natyrshme e historisë ushtarake të vendeve ku ata shërbyen dhe jetuan.

Shumica e ministrave të Luftës, apo siç u quajtën më pas, të Mbrojtjes, dhe e Kryetarëve apo e Shefave të Shtabit Madhor shqiptar, që erdhën në krye të këtyre institucioneve të rëndësishme të mbrojtjes së vendit, padyshim që u

përpoqën të bënin më të mirën. Ata, përveçse atdhetarë, bënë gjithçka për të qenë sa më profesionistë dhe luftuan gjatë kohës që drejtuan në postet e tyre të rëndësishme dhe luftuan, në tërësi, për të krijuar një ushtri me trajta dhe përmbajtje kombëtare, pse jo edhe me elementë modernë. Kjo dukuri nuk vërehet vetëm në fasadë apo thjeshtë në emërtim por, sidomos, në brendinë dhe përpjekjet e shumta që vijnë pikërisht nga historia e organizimit, drejtimit dhe veprimtarisë së kësaj ushtrie.

Mbas çlirimit të vendit, formimi i ushtarakëve shqiptarë u bazua kryesisht në arsimimin e tyre në akademitë e ish BS, derisa u hodhën bazat për krijimin e një serie shkollash ushtarake, të cilat luajtën pa dyshim rolin kryesor në përgatitjen e lidershipit ushtarak me vlera ushtarake të pa diskutueshme për vendin, por që në prizmin doktrinar nuk kishin asnjë lidhje me strukturën që pritej të ndërtohej në vend. E më pas në kohë, gati gjithë drejtuesit ushtarakë u arsimuan vetëm në shkollat shqiptare ushtarake, në një shkollë vërtet me karakteristika të spikatura, që luajti rol të dorës së parë në formimin e lidershipit ushtarak shqiptar.

Partneriteti midis Shqipërisë dhe NATO-s, si dhe me vendet anëtare të saj, rriti dhe intensifikoi bashkëpunimin politik dhe ushtarak, kontribuoi në angazhimin drejt parimeve të demokracisë dhe rritjes së stabilitetit, transparencës në buxhetin e mbrojtjes, thellimin e kontrollit demokratik në Ministrinë e Mbrojtjes, planifikimin e përbashkët, stërvitjet e përbashkëta ushtarake. Rol të veçantë luajti dhe pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e ushtarakëve në arsimim por veçanërisht pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në operacione të përbashkëta duke bashkëvepruar me forcat e NATO-s në fusha të tilla si paqeruajtja, operacionet e kërkim-shpëtimit dhe ato humanitare.

Prof. Dr. Proletar Hasani

Roli i lidershipit të lartë ushtarak në ngritjen, zhvillimin dhe drejtimin e institucioneve të mbrojtjes dhe të ushtrisë shqiptare

● *Roli dhe merita e lidershipit qëndron në faktin se ata i përmbushën objektivat strategjike të vëna nga Qeveria e Përkohshme përmes vështirësive të shumta, të nisur pothuajse nga asgjëja, në mungesë të plotë të trashëgimisë të institucioneve dhe organizimeve ushtarake. Nën udhëheqjen dhe kujdesin e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, ata ia dolën që t'i krijonin dhe vinin në funksionim institucionet e Mbrojtjes dhe të hidhnin hapat e para në organizimin ushtarak shqiptar.*

Qeveria e Përkohshme e Vlorës, e dalë nga mbledhja e Kuvendit Kombëtar, në përbërje të kabinetit të saj përfshiu edhe Ministrinë e Luftës (të Mbrojtjes Kombëtare), sepse në vizionin dhe strategjinë e saj, ndër shqetësimet e para dhe të ngutshme kishte edhe mbrojtjen e vendit. Për këtë arsye i nevojitej ngritja dhe organizimi i një force të armatosur, e një ushtrie sado të vogël, për t'u mbrojtur nga sulmet e fqinjëve.

Në ngritjen, zhvillimin dhe organizimin e institucioneve të Mbrojtjes dhe të organizimit të Ushtrisë Shqiptare, një vend dhe rol të rëndësishëm ka luajtur pa dyshim lidershipi ushtarak shqiptar. Kjo shenjë u duk që më 4 Dhjetorin e vitit historik 1912, me krijimin e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës te kryesuar nga kryeministri Ismail Qemali, e cila emëroi në drejtimin e dikasterit të Luftës, apo ndryshe Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare, një lider ushtarak të njohur, gjeneral brigade Mehmet Dërrallën (Tetovën) ai ishte një oficer karriere, me shumë përvojë organizimi dhe drejtimi ushtarak e luftarak, i cili njihej edhe si një prej komandantëve të shquar të kryengritjeve shqiptare të viteve 1910-1912.

Pikërisht për këto mangësi e vështirësi, ndërmarrja e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës për të përfshirë në përbërje të saj edhe institucionin e Luftës (Mbrojtjes Kombëtare), rolin e lidershipit ushtarak shqiptar e bëri më të dukshëm dhe të rëndësishëm.

Roli dhe merita e lidershipit të tyre qëndron në faktin se ata i përmbushën objektivat strategjike të vëna nga Qeveria e Përkohshme përmes vështirësive të shumta, të nisur pothuajse nga asgjëja, në mungesë të plotë të trashëgimisë të institucioneve dhe organizimeve ushtarake. Nën udhëheqjen dhe kujdesin e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, ata ia dolën që t'i krijonin dhe vinin në funksionim institucionet e Mbrojtjes dhe të hidhnin hapat e para në organizimin ushtarak shqiptar. Për këtë qëllim ata përgatitën dokumentin e parë që ishte "Rregullorja e ministrisë së Luftës", si dhe ligjin për "Organizimin e Milicisë Shqiptare", më 3 qershor të vitit 1913 deri në organizimin e Ushtrisë Shqiptare, me të gjitha strukturat e saj, veçanërisht të forcave aktive. Madje, u mendua nga ky lidership edhe përkthimi i terminologjisë ushtarake në gjuhën shqipe.

Në mungesë të organizimit të formacioneve ushtarake të rregullta shqiptare, për shkakë të kuptueshme, ministria e Luftës dhe Shtabi Madhor, drejtuan veprimet luftarake të formacioneve luftarake vullnetare dhe të atyre rezerviste në Jug të vendit, për të ndalur përparimin e trupave shoviniste greke, që synonin

pushtimin e territoreve shqiptare. Ndërkohë vijonin përpjekjet për organizimin e "Kompanisë model", që ishte nënreparti i parë i rregullt i Ushtrisë Shqiptare, sipas të cilit do të organizoheshin edhe nënrepartet dhe repartet e tjerë të kësaj ushtrie. Mund të thuhet se lidershipi ushtarak i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës hodhi themelet e institucionit të parë të Mbrojtjes në Shqipëri, si dhe shënoi fillimet apo shënjoji gjurmën e organizimit modest ushtarak shqiptar.

Një faqe e re u hap në historinë e popullit shqiptar me Kongresin e Lushnjës, në janar të vitit 1920, dhe qeverisë së dalë prej tij. Në Këshillin Kombëtar (Senati) u hodh ideja për ringritjen e Ministrisë së

Luftës dhe krijimin e organizimit e mirëfilltë ushtarak të Ushtrisë Shqiptare. Ministër i Luftës, u emërua gjeneral brigade Ali Riza Kolonja, një oficer i lartë i dalë nga Akademia Ushtarake turke dhe i kualifikuar në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm gjerman. Ai ishte një oficer me kulturë të gjerë, me përvojë drejtuese të pasur dhe me koncepte bashkëkohore. Së pari gjeneral Ali R. Kolonja evidentoi dhe mblodhi copëzat e nënreparteve dhe reparteve ushtarake shqiptare që qenë ngritur dhe vepronin në zona të ndryshme të territorit të Shqipërisë që nga koha e Luftës së Parë Botërore. Të tilla ishin disa nënreparte të "Milicisë Shqiptare" ("Milizia Albaneze"), që

vepronin në rajonin e Gjirokastrës dhe Delvinës. Gjithashtu edhe pak reparte ushtarake të organizuar në krahinën e Korçës, si dhe në Durrës e Elbasan.

Mbi bazën e tyre gjeneral Kolonja, i mbështetur nga Shefi i Shtabit Madhor, nënkoloneli energjik Ali Shefqeti (Shkupi), si dhe një grup oficerësh me përvojë të gjatë ushtarake, vendosën organizimin e Ushtrisë sipas sistemit modern "tresh", me tre regjimente. Kjo përbënte fillimet e organizimit ushtarak modern shqiptar, mënyrën dhe këndvështrimin bashkëkohor në përafrimin e institucionit të Mbrojtjes dhe të vetë organizimit ushtarak të Ushtrisë me modelet më të mirë dhe të përshtatshëm të kohës.

Që nga krijimi i dikasterit të Mbrojtjes dhe i Ushtrisë Shqiptare, deri në fundin e vitit 1990, kur në Shqipëri ra sistemi politik një partiak, lidershipi ushtarak përbëhej nga liderë të lartë, personalitete të fushës, që ishin, në përgjithësi, ushtarakë të karrierës, me grada të larta, si gjeneralë ose kolonelë, me përvojë në drejtim. Por, natyrisht, ata kishin formim ushtarak dhe kualifikime akademike të plota në kulturën ushtarake, disa edhe me kulturë të gjerë dhe në fusha të tjera si dhe njohës të gjuhëve të huaja. Të tillë ishin që nga ministri i parë i Mbrojtjes, Mehmet Dërralla, por edhe Kryetari i Shtabit Madhor, majori e më pas nënkoloneli Ali Shefqeti (Shkupi). Ata u pasuan nga ministri i Luftës, i pari në Qeverinë e dalë nga Kongresi i Lushnjës, gjeneral Ali Riza Kolonja, i kualifikuar në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm në Berlin, njohës i disa gjuhëve të huaja dhe më tej diplomat ushtarak si dhe pjesëtar në Komisionin Ndërkombëtar të Përcaktimit të Kufijve të Jugut të Shqipërisë, në vitet 1921 deri më 1925.



MSC. MIMOZA GOLIKJA

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mircea Geoana, mori pjesë në konferencën vjetore të Komitetit të NATO-s për Perspektivat Gjinore, më 7 dhjetor 2021. Z. Mircea Geoana diskutoi rëndësinë e integritetit të perspektivave gjinore në agjendën e NATO-s, nga operacionet dhe misionet deri te zhvillimi i aftësive dhe pajisjeve të reja. “Të sigurohemi që zërat e grave të dëgjohen dhe konsideratat gjinore të reflektohen në të gjithë spektrin e aktiviteve tona, nuk është thjeshtë një gjë e mirë, por është një domosdoshmëri për NATO-n.”, -tha Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm.

Konferenca vjetore e Komitetit të NATO-s për Perspektivat Gjinore, bën së bashku përfaqësues përkatës ushtarakë dhe civilë që punojnë në këtë fushë. Konferenca e këtij viti u fokusua në tematikën se si Aleanca mund të integrojë më tej perspektivat gjinore në vizionin e saj aktual dhe të ardhshëm, përmes agjendës së NATO-s 2030, përfshirë konceptin e ardhshëm strategjik të NATO-s, i cili do të miratohet në Samitin e NATO-s në Madrid në qershor 2022.

“Mbajtja e njerëzve tanë të sigurt, në një botë me konkurrese dhe më të lidhur, do të kërkojë të gjitha mjetet dhe talentet në dispozicionin tonë. Puna jonë për Gratë, Paqen dhe Sigurinë është pjesë përbërëse e kësaj, jo një shtesë.”, -u shpjegoi zoti Geoana delegatëve të këtij viti.

Perspektivat Gjinore, ndërveprim dhe vizion i përbashkët në NATO

Komiteti i NATO-s për Perspektivat Gjinore (NCGP) promovon integrimin gjinor si një strategji për t'i bërë shqetësimet dhe përvojat e grave dhe burrave një dimension integral të hartimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave, programeve dhe operacioneve ushtarake. Duke kështilluar udhëheqjen politike dhe ushtarake të NATO-s, si dhe vendet anëtare, për çështjet që lidhen me gjininë dhe zbatimin e Rezolutës 1325 të KS të Rezolutës dhe Rezolutat përkatëse, NCGP kontribuon në efektivitetin operacional në përputhje me objektivat dhe prioritetet e Aleancës. Përgjegjësitë e tjera të NCGP përfshijnë lehtësimin e shkëmbimit të informacionit midis anëtarëve të NATO-s mbi politikën e lidhura me gjininë dhe integrimin gjinor, sigurimin e koordinimit të duhur për çështjet gjinore me Strukturën e Komandës së NATO-s dhe Selinë e NATO-s, si dhe bashkëpunimin me organizatat dhe agjencitë ndërkombëtare që kanë të bëjnë me integrimin e një perspektivë gjinore në operacionet ushtarake.

“Është relativisht herët në mëngjes, por nuk është kurrë herët për të diskutuar në NATO për gjëra shumë të rëndësishme”, -tha në hyrje të fjalës së tij, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mircea Geoana, në Konferencën Vjetore të Komitetit të NATO-s për Perspektivat Gjinore (NCGP). “Ky vit shënon 45 vjetorin e Komitetit dhe 60 vjet që kur u mbajt Konferenca e parë e Lartë Zyrtare e Grave, duke kaluar në shumë vite e dekada të suksesshme në Aleancën e NATO-s. NATO e ka njohur prej kohësh rolin e rëndësishëm që luajnë gratë në sigurinë dhe mbrojtjen tonë. Në fakt, emri fillestar i këtij Komiteti, kur u krijua në vitin 1976, ishte Komiteti për Gratë në Forcat e NATO-s, dhe sot, nevoja për të integruar perspektivat gjinore në gjithçka që bëjmë si Aleancë

Të sigurohemi që zërat e grave të dëgjohen

Mircea Geoana: Koncepti ynë i ardhshëm strategjik nuk do të jetë i verbër ndaj gjinisë



është po aq e rëndësishme dhe ndoshta edhe më e rëndësishme se kurrë”, -tha ai. “Ne po jetojmë dhe e shohim këtë çdo ditë dhe këtu në NATO, e shohim çdo minutë, në një konkurrencë globale në rritje, me kërcënime gjithnjë e më komplekse për sigurinë e një miliardë njerëzve të 30 kombeve që i përkasin Aleancës tonë.”, -tha z. Geoana.

Të sigurohemi që zërat e grave të dëgjohen, domosdoshmëri për NATO-n

“Ne e dimë se gratë dhe vajzat janë të prekura në mënyrë disproporcionale nga dhuna dhe paqëndrueshmëria, por gjithashtu e dimë se ato luajnë një rol të domosdoshëm në krijimin e paqes dhe sigurisë së qëndrueshme. Kështu, që të sigurohemi që zërat e grave të dëgjohen dhe konsideratat gjinore të reflektohen në të gjithë spektrin e aktiviteve tona nuk është thjeshtë një gjë e këndshme, është një domosdoshmëri për NATO-n. Njëzet e një vite më parë agjenda e Grave, Paqes dhe Sigurisë u lançua nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së dhe që atëherë, NATO ka demonstruar përkushtimin tonë për të integruar perspektivat gjinore gjatë gjithë punës sonë.”, -nënvizoi në fjalën e tij Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s.

Në vitin 2007, NATO ra dakord për politikën e parë mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë dhe në Samitin e Lisbonës në vitin 2010, udhëheqësit e NATO-s ranë dakord për një plan veprimi për të integruar rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së në misionet dhe operacionet e udhëhequra nga NATO. “Që atëherë, këto janë përditësuar disa herë dhe po pasqyrojnë një kuptim gjithnjë e më të thellë se si aplikimi gjinor rrit punën tonë dhe forcon misionin tonë. Plani ynë aktual i veprimit u miratua në takimin tonë të fundit të ministrave të Mbrojtjes këtë tetor. Agjenda e Grave, Paqes dhe Sigurisë ka të bëjë pjesërisht me rritjen e përfaqësimit të grave në çdo nivel, si në anën politike ashtu edhe në atë ushtarake, nga më shumë çizme femrash në terren,

në më shumë vende për gratë, në tryezën e NATO-s, në pozicione drejtuese. Siç e përmenda edhe vitin e kaluar, shifrat po shkojnë në drejtimin e duhur, por kemi ende rrugë të gjatë për të bërë”, -tha z. Geoana. “Po aq e rëndësishme, puna jonë për Gratë, Paqen dhe Sigurinë ka të bëjë gjithashtu me aplikimin e një fokusi gjinor për gjithçka që bëjmë. Nga operacionet dhe misionet tona, ku të kuptuarit e nevojave dhe përvojave unike të grave në konflikt ose krizë na ndihmon të formojmë përgjigje më efektive, në zhvillimin e aftësive, në mënyrë që të sigurojmë që pajisjet që përdorim të jenë të përshtatshme për këdo që shërben. Ose për përpjekjet tona për të luftuar terrorizmin, mbrojtjen kibernetike dhe teknologjitë e reja, për të siguruar që të mos humbasim informacione, mundësi kritike ose të ndërmarrim rreziqe të panevojshme. Nuk duhet të jetë befasi që ndërsa shikojmë nga e ardhmja e Aleancës sonë të madhe, një fokus i fortë dhe gjithnjë e më i fortë gjinor do të mbetet një prioritet në të ardhmen.”, -nënvizoi ai.

Koncept i ri Strategjik, Agjenda për Gratë, Paqen dhe Sigurinë dhe përkushtimi i NATO-s ndaj barazisë gjinore

Në Samitin e Brukselit qershorin e kaluar, pikërisht në këtë seli, udhëheqësit e NATO-s morën vendime të guximshme përmes agjendës “NATO 2030”, për të forcuar NATO-n si “gur themeli” i sigurisë sonë dhe për të mbajtur të sigurt një miliard njerëzit tanë, tani dhe në të ardhmen. Kështu, ne morëm hapa për t'i bërë shoqëritë tona më të forta, infrastrukturën tonë më elastike dhe zinxhirët tanë të furnizimit më të larmishëm. Ne vendosëm ndryshimin e klimës në qendër të agjendës së NATO-s për herë të parë, jo vetëm për të reduktuar ndikimin e klimës në ushtritë tona, por edhe për të zvogëluar ndikimin e ushtrive tona në klimë. Ne kemi ndërmarrë veprime konkrete për të mpërhur avantazhin tonë

teknologjik duke nisur një përsheptues të ri të inovacionit të mbrojtjes dhe një fond inovacioni prej miliarda eurosh për të mbështetur teknologjitë e sotme me përdorim të dyfishtë për të zgjidhur sfidat e mbrojtjes dhe sigurisë të së nesërme”, -u shpreh z. Geoana. Gjithashtu në Samit, liderët e NATO-s i kërkuar Sekretarit të Përgjithshëm Jens Stoltenberg të zhvillojë Konceptin e ardhshëm Strategjik të NATO-s.

Z. Geoana tha se duke parë se sa shumë ka ndryshuar bota, kjo është edhe arsyeja pse Koncepti i ri Strategjik, që do të miratohet në Madrid në Samitin e qershorit, do të pasqyrojë mjedisin e ri të sigurisë i cili ka ndryshuar rrënjësisht në dekadën që nga ajo kohë, kur ai u miratua. “Prandaj Koncepti i ri strategjik duhet për të hartuar një rrugë të përbashkët përpara për Aleancën tonë, duke u përkushtuar sërish ndaj vlerave tona dhe ndaj themelit të domosdoshëm që janë vlerat tona dhe lidhja transatlantike. Ne do të miratojmë këtë Koncept të ri Strategjik që pasqyron botën e sotme, por edhe duke u përpjekur të parashikojmë sfidat e së nesërme. Por vizioni i NATO-s për të ardhmen nuk mundet dhe nuk do të jetë i verbër ndaj gjinisë, sepse një strategji që lë pas gjysmën e popullsisë nuk është një strategji për sukses dhe mbajtja e njerëzve tanë të sigurt në një botë me konkurrese dhe më të lidhur do të kërkojë të gjitha mjetet dhe talentet, punën e palodhur, disiplinën dhe sofistikimin e të gjithë potencialit në dispozicion nga e gjithë popullata e

Aleancës. puna jonë për Gratë, Paqen dhe Sigurinë është pjesë përbërëse e kësaj, jo një shtesë.”, -tha ai.

Si Aleancë, NATO është e përkushtuar ndaj barazisë gjinore. “Ne jemi të përkushtuar për të penguar dhe mbrojtur kundër çdo kërcënimi nga çdo drejtim. Ne jemi të vendosur të mbrojmë vlerat tona demokratike dhe rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla dhe po punojmë më ngushtë me të gjithë partnerët tanë për të arritur këto synime, civilë dhe ushtarakë, sektorin publik dhe privat, shoqërinë civile, burrat dhe gratë”, -tha në mbyllje të fjalës së tij Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mircea Geoana dhe theksoi edhe njëherë gjithë punën e vlefshme që bën ky Komitet për ta bërë Aleancën më të barabartë, më efektive, më të qëndrueshme dhe më të përshtatshme për qëllimin për shumë vite të gjata përpara.

Ai vlerësoi pjesëmarrjen gjatë konferencës ku u shqyrtuan mënyrat për të integruar më mirë perspektivat gjinore në të ardhmen në të gjithë spektrin dhe në mbarë botën përmes partneriteteve të vendeve, si dhe uroi për “këtë moment të mbarë” dhe “diskutimet shumë interesante”, në këtë aktivitet ku konferenca prezantoi rezultatet e punës së madhe të Agjendës së Grave Paqes dhe Sigurisë në. “Kjo është një pjesë e rëndësishme e asaj që jemi dhe kjo është një pjesë e rëndësishme e suksesit të qëndrueshëm të Aleancës sonë.”, -përfundoi z. Geoana.

NATO dhe Kolumbia bien dakord për një partneritet të ri

Më 8 dhjetor 2021, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, z. Mircea Geoana, u takua me ministrin e Mbrojtjes të Kolumbisë, z. Diego Andrés Molano, për të nisur një program të ri partneriteti. Kolumbia u bë partneri më i ri i NATO-s, në vitin 2017 dhe i pari në Amerikën Latine. Pas një sërë takimesh të nivelit të lartë dhe bisedimeve të stafit gjatë vitit 2021, Kolumbia dhe NATO kanë rënë dakord për një kuadër të ri bashkëpunimi, Programin e Partneritetit të Përshtatur Individual, duke shënuar fillimin e një bashkëpunimi edhe më të ngushtë. Kolumbia është partneri i parë që kalon në një program të tillë të ri, i cili mbulon fusha për bashkëpunim të zgjeruar si ndërveprueshmëria, ndërtimi i integritetit, trajnimi dhe edukimi, si dhe fusha të reja si ndryshimi i klimës dhe siguria. Në këtë kuadër, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s dhe ministri i Mbrojtjes kolumbiane hapën ekspozitën virtuale “Colombian Paramos and High Mountain Ecosystems”, e cila thekson rolin aktiv të Forcave të Armatosura Kolumbiane në zbutjen e ndryshimeve klimatike. Z. Geoana dhe z. Molano shkëmbyen gjithashtu mendime mbi implikimet e sigurisë, të ndryshimeve klimatike, dezinformimin, komunikimet strategjike dhe mënyrat për të adresuar kërcënimet kibernetike.



CEREMONIA E NDËRRIMIT TË KOMANDËS

NATO ripohon angazhimin e saj ndaj Bosnje-Hercegovinës

Më 7 dhjetor 2021, në Sarajevë, në Sallën ushtarake të Forcave të Armatosura të Bosnjës, u zhvillua ceremonia e ndërrimit të komandës, e cila kaloi nga gjeneral brigade Eric Folkestad tek gjeneral brigade Pamela McGaha. Gjeneral brigade Pamela McGaha emërohet në krye të shtabit të NATO-s, me seli në Sarajevë, në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Në aktivitet morën pjesë komandanti i Komandës së Forcave të Përbashkëta Aleate në Napoli, Admirali Robert P. Burke, zyrtarë civilë dhe ushtarakë nga Bosnja dhe Hercegovina dhe përfaqësues të komunitetit diplomatik.

Admirali Burke priti gjeneral brigade McGaha dhe ndërkohë falënderoi gjen-

eral brigade Folkestad për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në mision. “Për 17 vjet, kjo seli ka kërkuar të ndihmojë popullin e Bosnjë dhe Hercegovinës të

krijojë një të ardhme më të mirë, pasi NATO qëndron si partner i palëkundur me këtë komb krenar derisa puna të përfundojë.”, -tha ai.



Takimi i shefave të Mbrojtjes së NATO-s

Adresimi i sfidave aktuale të sigurisë me të cilat përballet Aleanca

Më 6 dhjetor 2021, 30 shefat e Mbrojtjes të NATO-s u mbledhën në një takim virtual të Komitetit Ushtarak, për të diskutuar mbi sfidat e sigurisë me të cilat përballet Aleanca, në të gjitha fushat operacionale dhe në të gjitha zonat gjeografike. Komandanti Suprem i Aleatëve në Europë informoi Komitetin Ushtarak, ashtu si edhe Ndihmës Sekretarin e Përgjithshëm për Inteligjencën dhe Sigurinë. Shefat e Mbrojtjes shkëmbyen informacione për të marrë një mirëkuptim kolektiv, në mënyrë që të forcohet frenimi dhe qëndrimi mbrojtës i Aleancës. Qëllimi i takimit ishte promovimi i transparencës midis aleatëve dhe përafrimi i aktiviteteve të vazhdueshme kombëtare dhe aleate. Komiteti Ushtarak, i kryesuar nga admirali Rob Bauer, është përgjegjës për këshillimin e autoriteteve politike të NATO-s mbi masat që konsiderohen të nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen e përbashkët të territorit të NATO-s dhe për zbatimin e vendimeve në lidhje me operacionet dhe misionet e NATO-s.



Stërvitja kryesore e NATO-s për mbrojtjen kibernetike në Estoni

Koalicioni Kibernetik 21, ishte një nga stërvitjet vjetore më të mëdha në botë për mbrojtjen kibernetike, (29 nëntor - 3 dhjetor 2021). Mbrojtës kibernetikë nga të gjithë aleatët e NATO-s, si dhe partnerët Finlanda, Irlanda, Suedia dhe Zvicra, ishin pjesëmarrës, gjithashtu kishte pjesëmarrës nga industria dhe akademitë. Në përgjithësi, rreth 1,000 personel u stërvitën në këtë stërvitje zhvilluar në Talin, Estoni, si dhe nga distanca, nga kryeqytetet kombëtare dhe vende të tjera. Stërvitja testoi dhe trajnoi ekspertë kibernetikë në aftësinë e tyre për të mbrojtur NATO-n dhe rrjetet kombëtare. Nga mbrojtja kundër malware-ëve, përmes sulmeve hibride që përfshijnë mediat sociale, te hakimet në pajisjet celulare, ushtrimi kishte një sërë skenarësh sfidues dhe realistë. Skenarët e këtij viti përfshinin një sulm kibernetik ndaj tubacioneve të furnizimit me gaz; një sulm kibernetik që pengonte dislokimin e trupave dhe logjistikës; dhe një sulm ransomware i lidhur me pandeminë, ku të dhënat e vaksinave

vidhen dhe programet e vaksinimit rrezikohen. Lojtarët nuk konkurruan, por bashkëpunuan, duke shkëmbyer informacione të dorës së parë, përvojën dhe praktikën më të mira në trajtimin e incidenteve kibernetike. Duke punuar së bashku, pjesëmarrësit individualë, si dhe organizatat e tyre, kombet dhe NATO, rrisin qëndrueshmërinë e tyre kibernetike. Për NATO-n, Koalicioni Kibernetik 21 është një mjet për të përmirësuar mbrojtjen e rrjetit IT të vetë organizatës dhe për të rregulluar mekanizmat e saj për shkëmbimin e informacionit në kohë reale me aleatët dhe partnerët. Stërvitja ishte gjithashtu një test i rëndësishëm i aftësisë së organizatës për të kryer operacione në hapësirën kibernetike dhe për të penguar dhe mbrojtur kundër kërcënimeve në fushën kibernetike. Për herë të parë, Koalicioni Kibernetik 21 u zhvillua në Zonën Kibernetike në Talin, një platformë për ushtrime kibernetike realiste, virtuale të operuara nga Forcat e Mbrojtjes së Estonisë.



Trajnim i avancuar për pilotët e avionëve luftarakë

Zgjidhen dy kampuse fillestare të trajnimit të pilotëve për fluturimet e avionëve të NATO-s në Europë

10 aleatët pjesëmarrës në Projektin e NATO-s për Trajnimin e Fluturimeve në Europë (NFTE) me dukshmëri të lartë, si Belgjika, Republika Çeke, Greqia, Hungaria, Italia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Rumania, Spanja dhe Turqia, më 2 dhjetor 2021, zyrtarisht caktuan dy kampuset fillestare të trajnimit NFTE. Ata arritën këtë moment historik vetëm gjashtë muaj pasi ministrat e tyre të Mbrojtjes themeluan zyrtarisht NFTE në prag të Samitit të NATO-s.

Dy kampuset e trajnimit NFTE të përzgjedhura, janë Qendra e Trajnimit të Fluturimit (CLV) në Pardubice, Republika Çeke, dhe Shkolla Ndërkombëtare e Trajnimit të Fluturimit (IFTS) që do të vendoset në Decimomannu, Itali. Të dy vendet do të ofrojnë mundësi trajnimi të avancuara për pilotët aspirantë të avionëve luftarakë të aleatëve pjesëmarrës. Studentët e parë të NFTE pritet të fillojnë trajnimin e tyre në kampuse që në vitin 2023.

Kjo shënon një moment historik fillestar kritik në ambicien e NFTE për të riformuar rrënjësisht peizazhin e trajnimit të ekuipazhit ajror në Europë drejt më pak fragmentimit, kostove më të ulëta të trajnimit dhe rritjes së ndërveprimit. Për këtë qëllim, pjesëmarrësit do të krijojnë gradualisht një rrjet të Kampuseve të Trajnimit NFTE që përfundimisht do të adresojnë të gjithë spektrin e kërkesave të trajnimit të ekuipazhit ajror të pjesëmarrësve, përfshirë pilotët me avion të shpejtë, me krahë fiks, helikopterë dhe dronë. Prandaj, zgjedhja e dy kampuseve fillestare të trajnimit NFTE është vetëm hapi i parë në një rrugëtim shumë ambicioz bashkëpunimi shumëkombësh.

Përgjigje ndaj pandemisë COVID-19

NATO dhuron sistemin e gjenerimit të oksigjenit në Irak

Iraku mori një sistem gjenerimi të oksigjenit me një stacion mbushjeje, si dhe 100 cilindra oksigjeni nga Stoku i Përgjigjes ndaj Pandemisë së NATO-s, për të ndihmuar vendin t'i përgjigjet infeksioneve të koronavirusit. Qendra e Koordinimit të Reagimit ndaj Fatkeqësive Euro-Atlantike e NATO-s, Agjencia për Mbështetjen dhe Prokurimin e NATO-s dhe Misioni i NATO-s në Irak koordinuan dhurimin (28 nëntor 2021) në përgjigje të një kërkesë të Irakut për ndihmë për COVID-19.

Transporti i pajisjeve mjekësore në Irak u sigurua nga Depoja e Përgjigjes Humanitare e OKB-së e Programit Botëror të Ushqimit, pas një kërkesë për mbështetje nga Qendra Euro-Atlantike e Koordinimit të Reagimit ndaj Fatkeqësive drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Italisë.

Donacioni iu dorëzua Ministrisë së Punëve të Jashtme të Irakut dhe do të rrisë kapacitetin mjekësor të Irakut për t'u përballur me pandeminë. Mbështetje e mëtejshme do t'i ofrohet Irakut për instalimin dhe funksionimin e pajisjeve.

Në vitin 2020, NATO krijoi një Fond Mirëbesimi për Reagimin ndaj Pandemisë, i cili mban një rezervë pajisjesh dhe furnizimesh mjekësore për të qenë në gjendje të ofrojë ndihmë të menjëhershme për aleatët ose partnerët në nevojë. Nëpërmjet Fondit të Mirëbesimit për Reagimin ndaj Pandemisë, Qendra Euro-Atlantike e Koordinimit të Reagimit ndaj Fatkeqësive të NATO-s ka ofruar këste të shumta të ndihmës për COVID-19 për 13 vende.



109 vite ushtri shqiptare

Krenaria e kombit shqiptar feston 109-vjetorin e krijimit të saj

Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të një shteti të pavarur, në Shqipëri, u formua më datën 4 maj 1913 në Vlorë. Formimi i Shtabit Madhuer u bë me miratimin e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Ai mban fillimisht emërtimin Shtati Madhuer dhe më tej u emërua “Shtabi Madhuer”, kryetar i të cilit ishte major Ali Shefqet Shkupi. Shtabi Madhuer e kishte qendrën në Vlorë, pranë Ministrisë së Luftës të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës që kryesohej nga Ismail Qemal Bej Vlora.

Në verën e vitit 1913 ky shtab ishte fare i vogël, ai përfaqësohej nga një zyrë që emërohej Zyra e Shtatit Madhuer të Ushtrisë, pranë Ministrisë së Luftës dhe ishte në përbërje e në varësi të kësaj ministrie. Në pikëpamje organizative Shtabi Madhor përbëhej nga “pjesët e nënzëshme”, që emërtohej në terminologjinë e fillim shekullit të kaluar si: “Qarqet e Shtatit Madhuer, Sekretaria e Shtatit Madhuer, Komisioni i rregulloreve e i ushtrimeve, Komisioni i trajnimit të policisë e të xhandarmërisë, Komisioni i ndërtimit”. Shtabi Madhor ishte konceptuar, ndërtuar, por edhe veprimi teorikisht e praktikisht si një organ bazë i Ministrisë së Luftës. Shtabi ishte përgjegjësi kryesor për organizimin, përgatitjen dhe drejtimin profesional të veprimtarisë luftarake të FA Shqiptare.

Në janar 1925, pas shpalljes së Republikës së parë të Shqipërisë, në bazë të Statutit Themeltar ose Kushtetutës, si një strukturë përbërëse, gjithsesi modeste, mbeti Shtabi Madhor. Me vënien në zbatim të organikës së re të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, në postin e kryetarit të Shtabit u emërua koloneli



austriak Gustav Von Myrdac, i cili kryente njëherësh edhe detyrën e organizatorit të Ushtrisë Shqiptare, që e kryente që prej vitit 1922. Kryetari i Shtabit Madhor përzgjidhej nga radhët e oficerëve të lartë të karrierës, që të zotëronte përvojë të spikatur për organizimin, drejtimin, stërvitjen dhe planifikimin dhe njëherazi të ishte një prej organizatorëve të Ushtrisë.

Pas vitit 1932 Shefi i Shtabit Madhor u rrit në gradë, për vetë rëndësinë e postit dhe të detyrave që ai kryente në Ushtrinë Kombëtare Shqiptare. Është fakt historik se vetëm në vitin 1922 ka pasur nënministër Mbrojtje dhe gjithë periudha deri në 1939-40 ka qenë pa zëvendësministra. Në vitet 1941-1942, ka pasur vetëm Sekretar të Përgjithshëm por pa të drejta për firmosje

në qeveri. Në mungesë të ministrave mund të firmoste vetëm një ministër qoftë edhe i një ministrie tjetër, por jo sekretari i Përgjithshëm. Pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste, më 7 prill 1939, Ushtria dhe krejt forcat e Armatosura Shqiptare, ashtu si dhe Shteti dhe institucionet e tjerë të tij u bashkuan dhe u njësuan me ato Italiane. Pra nuk flitej dhe nuk ekzistonin më Forcat e Armatosura Kombëtare. Përpjekje për të bërë “... rikrijimin e Ushtrisë Shqiptare të Shtetit Shqiptar”, duke ngritur edhe “Komandën e Përgjithshme të fuqive të armatosura”, u bënë nga Këshilli i Naltë i Regjencës, në nëntor të vitit 1943. Për këtë arsye Komiteti Ekzekutiv Provizor shpalli se “rihynte në fuqi Kodi Penal Shqiptar dhe gjithë ligjet e rregulloret e dhëna për Ushtrinë

Shqiptare, përpara datës 7 prill 1939”.

Në gusht 1946 Kryetari i Shtatmadhorisë u emërua Mehmet Shehu, në vend të gjeneralmajor Spiro Moisiut. Që nga 1 tetori i vitit 1946, pasi u suprimuan Komandat dhe disa seksione dhe u krijuan drejtoritë e seksionet e reja, kaluan në vartësi të drejtpërdrejtë të Shtabit të Përgjithshëm 7 Drejtori: Prapavija, Artileria, Ndërlidhja, Xhenio, Mbrojtja Bregdetare, Operative dhe e Organizim-Mobilizimit, si dhe 10 seksione: i Zbulimit, Sekretariati i Shefit të Shtatmadhorisë, Shërbimi i Brendshëm i Shtatmadhorisë, i Prapavijës i Shtatmadhorisë, i Kimisë, i Tankeve dhe Autoblindave, i Aviacionit, i Stërvitjes Luftarake, i Shifrës, i Topografisë. Në vitin 1952, gjeneralmajor Petrit Dume emërohet Shef i Shtabit të Përgjithshëm, i cili u zëvendësua nga gjeneralmajor Arif Hasko në vitin 1954. Në vitin 1956 gjenerallejtënant Petrit Dume riemërohet Shef i Shtabit të Përgjithshëm, i cili qëndroi në këtë post deri në korrik 1974. Më vonë realizoheshin detyrat e gatishmërisë luftarake, të plotësimit, të drejtimit dhe të përgatitjes së komandave e shtabeve. Me riorganizimin në 1966, Shtabi i Përgjithshëm përbëhej nga katër drejtori: Drejtoria Operative, e Zbulimit, e Organizim-Mobilizimit dhe e Ndërlidhjes; dhe nga shtatë degë autonome: e MKK, e Shifrës, e Topografisë, e Administratës, Ekonomike, e Stërvitjes luftarake dhe e Shërbimit, strukturë e cila nuk ndryshoi deri në vitet ‘80-të. Nga Shtabi i Përgjithshëm nuk vareshin Komandat e Korpuseve, Drejtoria Politike, Drejtoria e Xhenios, Komanda e MBL, Komanda e Artilerisë, Prapavija dhe Forcat e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

26 SHEFAT E SHTABIT TË PËRGJITHSHËM



1. Nënkolonel Ali Shefqet Shkupi, personalitet në Ushtrinë osmane, ish-komandanti i garnizonit të Stambollit me gradën “binbash”. Nënkolonel Ali Shefqet Shkupi ka qenë shef i Shtatmadhorisë së parë Shqiptare me funksionet e komandantit suprem të ushtrisë shqiptare në qeverinë e Ismail Qemal Vlorës.



2. Gjeneral Ali Riza Kolonja përveç detyrës si Ministër Luftime, në Ushtrinë Kombëtare Shqiptare në vitet ‘20, pas Kongresit të Lushnjës me Kryeministër Sulejman Delvinën, ka kryer edhe detyrën e Kryetarit të Shtabit Madhor si dhe njëherësh edhe detyrën e Komandantit të vetëm të Divizionit që kishte në atë kohë Shqipëria. Ai ishte

lindur në Kolonjë, më 1880 dhe u arsimua në Manastir, në Stamboll ndërsa akademinë e shtabit e kishte kryer në Gjermani. Kishte kulturë të gjerë ushtarake, prirje në diplomacinë ushtarake dhe zotëronte pesë gjuhë të huaja. Në 1922 ishte pjesëtar në Komisionin Ndërkombëtar të Katër Fuqive nënshkruese për kufijtë e Shqipërisë.



3. Major Xhavid Leskoviku ka lindur më 2 maj 1882 në Leskovik. Ndoqi studimet në Akademinë e Luftës në Stamboll për degën e këmbësorisë (Pyade). Është titulluar oficer më 1 gusht 1907, duke shërbyer për gjashtë vite me radhë në ushtrinë osmane në disa detyra. Por, më 1 janar 1913 hyn në shërbim

të Ushtrisë Kombëtare shqiptare. Ai shërbeu në qeverinë e Ismail Qemalit si dhe në ushtrinë e Vilhelm Vedit. Me krijimin e ushtrisë, nga fundi i vitit 1920, emërohet kryetar i Shtatmadhorisë, ndërkohë që ministër Luftime ishte gjeneral Ali Riza Kolonja.



4. Major Bajram Fevziu ka qenë i njohur si një nga drejtuesit e Shtabit Madhor, por njëherësh edhe si personalitet politik i botës shqiptare së cilës i përket. Bajram Fevziu u lind më 1884 në Kolonjë. Me përfundimin e shkollës së mesme shkoi në Stamboll ku përfundoi studimet në Akademinë Ushtarake, në vitin 1906. Më 1908 kreu studimet në Akademinë e njohur të Shtatmadhorisë në Vjenë.



5. Gjeneral Gustav Von Myrdac me origjinë austriake, ishte në postin e kryetarit të Shtabit madhor, i cili kryente njëherësh edhe detyrën e organizatorit të Ushtrisë Shqiptare, që e mbante qysh prej vitit 1922. Ai kishte lindur më 7 dhjetor 1876 në Vjenë.



6. Gjeneral Spiro Moisiu lindi në vitin 1900 në qytetin e Kavajës. Pasi mbaroi shkollën unike në qytetin e Kavajës dhe Durrësit, Spiro u dërgua për të ndjekur gjimnazin në Vjenë të Austrisë. Pas kthimit nga Austria, aty nga viti 1918-1919, ai mbaroi një kurs disa mujor në shkollën e

plotësimit të oficerëve në Tiranë.



7. Gjeneralcolonel Mehmet Shehu lindi më 10 janar 1913, në fshatin Çorrush të Mallakastrës. Në vitin 1932 përfundon shkollën teknike. Shkon në Napoli për të studiuar në Kolegjin Ushtarak, ku përjashtohet për ide revolucionare nga ky kolegji.



8. Gjenerallejtënant Beqir Balluku lindi më 14 shkurt 1917 në Tiranë. Studioi në Shkollën Teknike të Tiranës. U përfshi në lëvizjen komuniste qysh gjatë kohës që kryente shërbimin ushtarak 1940 deri 1942. Më 20 maj 1943 u caktua komandant i batalionit partizan “Krujë-Ishëm”, më 18 shtator 1943 komisar i brigadës së tretë dhe më pas komandant i Br2S.

Më 28 janar 1948 ishte emëruar kryetar i Shtatmadhorisë së Ushtrisë. Kreu në Moskë Akademinë Ushtarake “Voroshilov”.



9. Gjenerallejtënant Arif Hasko Mema lindi në Tërbaç të Vlorës dhe i njohur gjatë LIIB me pseudonimin “Patrioti”, gjatë luftës për çlirimin e vendit. Pasi mbaroi filloren në vendlindje, vazhdoi shkollën tregtare në Vlorë. Ai

ka udhëhequr në LANÇ formacione të rëndësishme partizane që nga Vlora e deri në veri të Shqipërisë . Në dhjetor të 1943-it, inkadrohet në BrIS, duke kryer detyra të ndryshme, deri komisar politik i kësaj brigade. Mbas çlirimit kryen Akademinë e Lartë të Shtabit të Përgjithshëm në Bashkimin Sovjetik.



10. Gjen.allejtënant Petrit Dume lindi më 20 maj të vitit 1920, Partizan, Komandant brigade, Komandant divizioni, shpallur Hero i Popullit me vendim të Qeverisë Politike e Byrosë së PPSH-së, e më pas në vitin 1974 u shpall Armik i Popullit.



11. Sami Meçollari ishte Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, për një periudhë të shkurtër në vitin 1974; ka qenë drejtues i spikatur i Formacioneve të mëdha ushtarake. Lindi në Marjan të Oparit në Korçë, më 10 mars 1937. Ka kryer shkollën e mesme ushtarake “Skënderbej” dhe SHBO me rezultate të shkëlqyera, ku u titullua oficer.



12. Veli Llakaj ka lindur më 18 shkurt 1935 në Kras të Tepelenës. Në vitin 1951 mbaron shkollën 7-vjeçare në vendlindje. Në vitet 1951-1954 punon në gjeologji e tregti në Memaliaj. Në vitin 1954 shkon student në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, të cilën e mbaron më 1957 me rezultate të shkëlqyera dhe i jepet grada më e lartë toger. Me mbarimin e shkollës në vitin 1957 emërohet në Shkollën e Bashkuar komandant Toge,



13. Kiço Mustaqi ishte një ushtarak karriere që kishte lindur më 22 mars 1938, në një fshat pranë Delvinës, Sarandë. Në detyrën e Ministrit të Mbrojtjes vjen pasi kishte kryer detyrën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare për nëntë vite rresht. Në shkurt të vitit 1991 ngarkohet me detyrën e Ministrit të Mbrojtjes të Shqipërisë në përbërje të qeverisë së Kryeministrit Fatos Nano dhe u largua nga detyra me dorëheqjen e qeverisë, në qershor të po atij viti.



14. Kolonel Halim Abazi ka lindur në dhjetor të vitit 1944 në Tërbac të Vlorës. Ka kryer të gjithë llojet e arsimimit ushtarak shqiptar, të cilat i ka përfunduar me rezultate të shkëlqyera. Kështu në vitet 1953-1960 kreu studimet në shkollën ushtarake “Skënderbej” ; në vitet 1960-1964 ka kryer Shkollën e Bashkuar të Oficerëve dhe në vitet 1970-1972 Akademinë e Mbrojtjes. Ka kryer detyra të nivelit më të lartë në ushtrinë shqiptare, përfshi edhe ato në nivelet e shkollave ushtarake.



15. Gjen.almajor Kostaq Karoli, lindi në dhjetor të vitit 1945 në Korçë. Ka qenë ushtarak i talentuar, ka kryer të gjithë llojet e arsimimit ushtarak shqiptar, të cilat i ka përfunduar me rezultate të shkëlqyera. Në qershor 1991 deri në gusht 1992 ka kryer detyrën madhore të shefit të SHP. Ka komanduar FA-të kur kishin një efektiv të madh, si aktiv ashtu edhe rezervist, me rreth 16500 oficerë, 9000 nënoficerë, 60000 ushtarë e 8000 civilë, rezervistë rreth 450000 vetë dhe 230000 forca vullnetare. Me 22 divizione dhe tre forca që ishin: mbrojtja kundërajrore, flota luftarake-detare dhe aviacioni. SHP kishte nën komandë 127 brigada këmbësorie, brigada artilerie dhe brigada sulmuese; rreth 1050 tanke, rreth 4000 gryka zjari artilerie tokësore; 34 regjimente të artilerisë kundërajrore, pa llogaritur artilerinë kundërajrore të brigadave, etj. Në kufi, mitralozat e rëndë (armët roje), bateritë e gatshme të artilerisë kundërajrore, hapnin zjarr për 2-3 minuta. Për 20-30 minuta, batalionet mitraljerë në vijën e kufirit ishin bërë gati për luftim; për 15-20 minuta, artileria tokësore e gatshme kishte hapur zjarr. Ka punuar dhe punon në sektorët shkencorë ushtarakë me titullin akademik “profesor”



16. Gjen. Ilia Vasho ka lindur më 10 korrik 1944, në Leskovik. Ka kryer të gjithë llojet e arsimimit ushtarak shqiptar, si dhe kualifikimet më të larta ushtarake. Kështu në vitet 1962-1964 ka kryer Shkollën e Bashkuar të Oficerëve dhe në vitet 1976-1978 Akademinë e Mbrojtjes. Ka kryer detyra të nivelit më të lartë në ushtrinë shqiptare, përfshi edhe ato në nivelet e shkollave ushtarake. Mbante gradën shkencore “Doktor Shkencash”.



17. Gjen. me katër yje, Sheme Kosova. Në periudhën 1994-1997 ka kryer detyrën madhore, shef i Shtabit të Përgjithshëm. Sheme Kosova lindi në 24 mars 1949. Ndoqi studimet në Shkollën e Mesme Pedagogjike në 1967 dhe Shkollën e Lartë të Bashkuar në vitin 1971, ndërsa në vitet 1979-1981 ka përfunduar studimet në Akademinë Ushtarake. Ka kryer detyra të nivelit më të lartë në ushtrinë shqiptare deri në shef i Shtabit të Përgjithshëm i Forcave të Armatosura Shqiptare. Në 2 mars 1997 lirohet nga kjo detyrë madhore.



18. Gjen.almajor Adem Çopani ka lindur në korrik të vitit 1944 në Tiranë. Ka kryer të gjithë llojet e arsimimit ushtarak shqiptar, të cilat i ka përfunduar me rezultate të shkëlqyera si shkollën ushtarake “Skënderbej”; Shkollën e Bashkuar të Oficerëve dhe Akademinë e Mbrojtjes. Ka kryer detyra të nivelit më të lartë në ushtrinë shqiptare, përfshi edhe ato në nivelet e shkollave ushtarake. Në vitet 1991 deri në mars 1997 ka kryer detyrën e Këshilltarit ushtarak të Presidentit të Republikës.



19. Gjen.almajor Aleks Andoni ka lindur më 8 qershor 1956 në fshatin Vuno të Vlorës. Ka kryer arsimimit ushtarak në shkollën ushtarake “Skënderbej”; në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve; në Akademinë e Mbrojtjes si dhe kualifikimin pasuniversitar për pedagogji e psikologji. Ka kryer detyra të nivelit më të lartë në ushtrinë shqiptare, përfshi edhe ato në nivelet e shkollave ushtarake. Në vitet 1992 deri në gusht 1997 ka dalë oficer në rezervë si rezultat i reformës ushtarake.



20. Gjen.allejtënant Pëllumb Qazimi ka lindur në vitin 21.10.1957 në Skrapar. Në vitin 1981 ka përfunduar Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve; në 1991 u diplomua në Akademinë e Mbrojtjes, në 1992 kreu kursin për “Refugjatët”, Hungari, kursin për “Ligjshmërinë Ndërkombëtare për Refugjatët”, në Itali; në 1994 kreu kursin për “Orientimin dhe planëzimin e operacioneve”, në Turqi; në 1995 kursin “Zbulimi Strategjik”, SHBA; në 1996 u diplomua në Kolegjin e Mbrojtjes, Tiranë; në 1996 kursin e NATO-s “Oficer shtabi për operacionet”, Holandë; në 1998 kursin për “Ligjin e Luftës”, Itali;



21. Gjen.almajor Luan Hoxha ka lindur më 28 mars 1960 në Shkodër dhe ka qenë Shef i Shtabit të Përgjithshëm i Forcave të Armatosura nga viti 2006-2008. Pas diplomimit në 1983 e deri në 2008 ka kryer detyra të larta deri në shef shtabi, si dhe kualifikime të shumta por shpërthimi që ndodhi në 15 mars 2008 i ndërpreu edhe karrierën ushtarake, kur ishte ngjitur deri në detyrën më madhore të ushtarakut..



22. Gjen.almajor Maksim Malaj ka lindur më 13.12.1958. Ka përfunduar Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve si dhe më vonë shumë kualifikime. Në 1981-1982 ka qenë instruktor i Përgatitjes së Zjarrit në Shkollën e Instruksionit, Zall Herr; më tej për pesë vite ishte instruktor Stërvitjeje; Instruktor në Degën e Stërvitjes në Divizionin e 8-të të Këmbësisë; Komandant Batalioni këmbësorie e territorial; në vitin 1992-1993 instruktor në

Degën e Stërvitjes në Divizionin e 8-të të Këmbësisë; në 1993-1994 Shef Operacional në Njësinë Ushtarake Nr. 1105; në 1994-1997 instruktor në Degën e Stërvitjes në Divizionin e 8-të të Këmbësisë; në 1997-2005 inspektor në Drejtorinë e Inspektimit të Ministrisë të Mbrojtjes në 2005-2007, Shef Shtabi dhe në 2008, Komandant i Br.R.SH.



23. Gjen.almajor Xhemal Gjunksi ka lindur në Peshkopi, më 30 janar 1963. Ai filloi jetën ushtarake në vitin 1977 në SHMU “Skënderbej”. Në vitin 1985 u diplomua nga Akademia Ushtarake, ku pas saj filloi karrierën e tij ushtarake si komandant toge. Gjatë karrierës së tij, ka qenë komandues, toge, kompanie, batalioni, brigade. Ka kryer kolegjin e Luftës së Forcave Tokësore në Turqi, ku u diplomua në vitin 1998. Nga viti 1998 deri në vitin 2004 ka kryer detyra të ndryshme në Shtabin e Përgjithshëm dhe Ministrisë së Mbrojtjes. Ai ishte Atashe i Mbrojtjes Shqiptare në Turqi që nga viti 2004 deri në vitin 2007. Në vitin 2007, u diplomua në Kolegjin e Mbrojtjes.



24. Gjen.almajor Jeronim Baze. Lindi në Tiranë, në maj 1960. Mbaroi studimet universitare në Akademinë Ushtarake “Skënderbej”, në Tiranë, në vitin 1985 dhe u titullua oficer aktiv. Kolonel Baze u emërua në 2012 këshilltar ushtarak i Presidentit të Republikës Nishani dhe më pas Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, në nëntor 2013.



25. Gjen.almajor Bardhyl Kollçaku, Shefi i Shtabit i 25-të, i 105 viteve ushtri shqiptare. Gjen.almajor Bardhyl Kollçaku ka lindur më 05 qershor 1967, në Pëllumbas, Berat. Ka përfunduar studimet në Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej”, Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve dhe është titulluar oficer aktiv në specialitetin “zbulim”, në vitin 1990. Gjatë karrierës së tij ushtarake ka kryer Kolegjin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen, Tiranë, Kolegjin e Shtabeve të Bashkuara, si dhe Kolegjin e Komandës dhe Shtabit në SHBA. Ka përfunduar studimet për master shkencor në Administrim Publik (UT), në bashkëpunim me Universitetin e Nebraskës, si dhe ka mbaruar doktoratën në fushën e Mbrojtjes. Gjen.almajor Kollçaku ka përfunduar gjithashtu Kursin e Lartë Ndërkombëtar të Menaxhimit të Mbrojtjes, si dhe Kursin Ndërkombëtar të Oficerit për Taktikë dhe Inteligjencë në SHBA.



26. Gjen.almajor Prof. Asoc. Bajram Begaj Gjen.almajor Bajram Begaj ka lindur më datë 20 mars 1967, në Rrogozhinë. Në vitin 1989, gjen.almajor Begaj ka përfunduar studimet pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë, Dega Mjekësi e Përgjithshme dhe është titulluar oficer aktiv në specialitetin “Mjekësi” në vitin 1998.Përpara se të merrte detyrën e shefit të Shtabit të Përgjithshëm, gjen.almajor Prof. Asoc. Bajram Begaj, për një periudhë tre vjeçare, ka shërbyer në detyrën e komandantit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes.. Gjatë karrierës së tij ushtarake, gjen.almajor Bajram Begaj ka shërbyer në pozicione të ndryshme drejtuese në Forcat e Armatosura, si: zëvendës drejtor i Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”; drejtor i Përgjithshëm i Spitalit Ushtarak Qendror Universitar; drejtor i Inspektoratit Shëndetësor, kryeinspektor dhe këshilltar i Inspektoratit Shëndetësor në Shtabin e Përgjithshëm të FA; shef i Njësisë Mjekësore Ushtarake dhe zëvendës drejtor i Spitalit Universitar të Traumës, si dhe detyra të tjera në strukturat e Forcave të Armatosura. Gjen.almajor Begaj ka ndjekur kualifikime dhe specializime të ndryshme në fushën ushtarake dhe atë mjekësore, në institucionet arsimore brenda dhe jashtë vendit. Ai ka përfunduar Kursin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen pranë Akademisë së Forcave të Armatosura, Shkollën e Thelluar Pasuniversitare të Mjekësisë dhe specializimin pasuniversitar në profilin Gastrohepatologji, pranë Fakultetit të Mjekësisë Tiranë.Gjithashtu ka ndjekur kursin e menaxhimit spitalor dhe kursin e lidershipit mjekësor strategjik, në SHBA, Kursin e Lartë Ndërkombëtar të Menaxhimit të Mbrojtjes, pranë Institutit të Menaxhimit të Burimeve të Mbrojtjes në Shkollën Pasuniversitare të Marinës në SHBA, Seminarin e Lartë Ekzekutiv pranë Qendrës Marshall, Gjermani, si dhe kurse e kualifikime të tjera ushtarake. Gjen.almajor Bajram Begaj, ka përfunduar “Doktoratën në Fushën e Mjekësisë”, pranë Fakultetit të Mjekësisë si dhe mban titullin “Profesor i Asociuar” në Mjekësi. Njëkohësisht është vlerësuar me medalje të ndryshme për arritje gjatë karrierës së tij ushtarake.

Botimi

Sfetigradi (Fundi i një enigme)

Doli në qarkullim, nga shtëpia botuese 2M Printing, libri “Sfetigradi (Fundi i një enigme)”, i autorit Ramazan Kica, me redaktor Sali Onuzin dhe perkujdesje grafike nga Ali Hyka.

Vendndodhja e kalasë së Sfetigradit, enigma më e madhe e Ballkanit, ka qenë një çështje e pasaktësuar nga historiografia jonë. Deri në vitin 2002, përgjithësisht historia jonë ka menduar se Sfetigradi ishte në Koxhaxhik, në zonën Zhupa të Maqedonisë. Ndërsa në fillim të shekullit XXI, historia zyrtare e Shqipërisë, Sfetigradin e identifikoi në Sopotnica të zonës Demir Hisar, dhe më tej (në vitin 2005), e vendos atë në shpatin verior të malit Dervenik, pranë fshatit po me të njëjtin emër, në anë të fushës së Pelagonisë.

Këto përfundime mbi vendndodhjen e Sfetigradit nuk janë të sakta, sepse bien në kundërshtim me çfarë shkruan Barleti për Sfetigradin; çështje të trajtuara hollë në libër.

Studimi vërteton, me fakte dhe argumente shkencorë, të vërtetën që kalaja e Sfetigradit ishte në majën shkëmbore Vrteska të Parkut Kombëtar “Peristeri”, në Maqedoninë e Veriut (në koordinatat: 41°02'39" V, 21°06'29" L, 2010 m), që shtrihet në anën lindore të Resnjës; në anën perëndimore të Manastirit; në anën jugore të rrugës Egnatia, që lidh fushën e Resnjës me Manastirin. Në veri është mali Biglla, i cili ndahet nga mali Peristeri prej kreshtës së Peristerit (qafa e Peristerit), ku kalon rruga Egnatia, nga Ohri në Manastir.

Nga studimi i terrenit, dhe sipas shpjegimeve që bën Barleti në të gjitha faktet dhe rrethanat që përshkruan, ushtritë osmane kanë hyrë drejt territoreve të Epirit nga dy drejtime kryesore:

- nga verilindja, nga Shkupi drejt Mokrës;

- si dhe nga juglindja, nga Manastiri (fusha e Pelagonisë) drejt Ohrit, nëpër rrugën “Egnatia”.

Natyrish që kalaja e Sfetigradit do ishte në rrugëkalim kryesor nga hyhet drejt Epirit nga juglindja, pra në segmentin e rrugës Egnatia, nga Manastiri në Ohër.

Fakti që Sfetigradi qëndronte në majën Vrteska, si roje besnike e qafës Peristeri të rrugës Egnatia që ishte porta e hyrjes në Epir, vërtetohet me pozicionin e tij ushtarak, topografik e historik. Ajo që thotë Barleti, se me rënien e tij u hap një portë e rrënuar drejt Epirit, është pikërisht kreshta e Peristerit (qafa e Peristerit) ku kalon rruga Egnatia, të cilës i mungonte roja nga sipër. Vetëm prania e njëmijë forcave në Vërteshka (rreth 850 metra mbi kreshtën e Peristerit), qafën e Peristerit e bënte të pakalueshme për ushtritë osmane, sepse një numër i tillë ushtarësh, duke zbritur “nga qielli”,



mund të shpartallojnë duke e goditur nga prapa, çdo lloj force ushtarake. Aty është burimi Dobrida (siç shkruan Muzaka), e cila është jo vetëm vija që ndan kufirin Shqipëri-Bullgari në Mesjetën e vonë, por edhe qafa, rruga e hyrjes në Epir. Kalaja e Sfetigradit, në anën jugore të qafës së Peristerit, në majën Vërteshka, jo vetëm e kishte nën vëzhgim dhe e mbronte këtë vendkalim, këtë portë hyrje drejt Epirit por ajo vëzhgonte gjithë hapësirën rreth e qark. Por, më kryesorja, atë nga lindja deri në fushën e Pelagonisë, që ishte drejtimi i vetëm nga mund të vinin ushtritë osmane drejt Epirit nga juglindja.

Vlerën dhe rëndësinë e kësaj porte e ka shprehur vetë Skënderbeu para ushtarëve në Sfetigrad: “Fati (i atdheut) varet nga ju, sepse nga ju do t’ia fillojë Murati hyrjes në Epir. Ju, që t’jua them vetë rrezikun që ju pret, do të ju sulmojë të parët tërbimi barbar, me qëllim që pastaj së këndejmi, si nga një portë e rrënuar e Epirit, t’i lëshohet gjithë vendit.”

Që Sfetigradi ishte në Vërteshka e vërtetojnë konceptet e përgjithshme ushtarake të lëvizjes së ushtrive osmane drejt Epirit, të shkruara nga Barleti dhe Frangu. Sa kohë që Sfetigradi ishte në duart e Kastriotit, asnjë ushtri osmane nuk tentoi Epirin nga rruga Egnatia, nga kreshta e Peristerit. Ato lanë kockat në qafën e Korabit, në hyrje të Mokrës dhe në ngushticat e saj plot gryka shkëmbinjsh e dushqe.

Gjithashtu, që Sfetigradi ishte në Vërteshka e vërtetojnë veprimet ushtarake të shkruara nga Barleti, ku ne jemi në gjendje të ndërtojmë të gjitha veprimet luftarake, si të otomanëve kundra rojës epirote të Sfetigradit, po ashtu dhe të ushtrisë epirote kundër rojës turke të Forcomës, dhe këto, fakte që vërtetojnë se Sfetigradi është aty në Vërteshka.

Pozicioni i malit Peristeri plotëson të gjitha kushtet për Sfetigradin, ashtu siç ato na i ka sjellë te ne Barleti me të gjitha rrethanat konkrete të terrenit, si format, rrethimet natyrore me shkëmbinj dhe me mure, maja, lartësia, pjerrësia, gunga mbi majën e malit që mbronte qytetarët nga predhat, shpatina Bivak nga gjuheshin muret me përdredhore shumë të mëdha, mungesa e ujit etj., dhe të gjitha imtësitë e ndryshme përputhen me të dhënat që shkruan Barleti.

Të gjitha të dhënat e tjera nga Barleti, e deri te përshkrimi i betejave të ndërmjetme mes Kastriotit dhe otomanëve (ndërkohë që Tirani mbante të rrethuar Sfetigradin), si dhe beteja e Skënderbeut me Ballabanin në fushën shumë të gjerë të krahinës së Sfetigradit në vitin 1465, shpjegohen me terrenin e malit Peristeri dhe fushës së Resnjës.

Rruga 25 km (tërheqja) e Kastriotit (siç shprehet dhe Barleti), nga Sfetigradi në kampin e Dibrës së Sipërme (të cilën e përshkonte Epiroti gjatë kohës që Murati mbante të rrethuar

Sfetigradin), që përshkruan Barleti, përputhet me rrugën në terrenin konkret nga fusha e Resnjës në kodrën e Straishtës (Dibër e Sipërme).

Me këtë zbulim merr fund enigma e Sfetigradit.

Historiografia shqiptare nuk është marrë seriozisht me përcaktimin e vendndodhjes së Sfetigradit, dhe jo vetëm të tij. Pikërisht, nga kjo mungesë e një studimi të kujdesshëm dhe të mbështetur nga faktet në terren, historia jonë ka konkluduar pa argumente, duke e çuar kalanë e Sfetigradit njëherë këtu e njëherë atje.

Me rënien e Sfetigradit u hap porta e Juglindjes së Epirit për ushtritë osmane, të cilat tashmë hynin pa pengesa deri në territoret më të brendshme të Skënderbeut.


Ne nuk mund të sjellim këtu, të gjitha imtësitë që jep Barleti për Sfetigradin, por mali Peristeri së bashku me majën shkëmbore Vrateska, plotëson gjithçka shkruan Shkodrani për Sfetigradin. Sfetigradi mbrohej nga natyra. Rrethim mbrojtës nga dora e njeriut (mure të thata, pa llaç), kishte vetëm në krahun e veriut. Nga maja e gungës, duke u larguar (duke zbritur) drejt veriut, në largësi rreth 50 metra është muri i parë i rrethimit të kalasë. Nga muri (rrethimi) i parë deri tek muri (rrethimi) i dytë, është një largësi nga 10 deri 15 metra. Muri (rrethimi) i tretë është rreth 20 metra larg të dytit. Ndërsa, në anën e perëndimit



kjo largësi totale prej rreth 80 metra, shtyhet (duke u ngushtuar) duke shkuar në total mbi 200 metra, dhe më shumë. Sot muret janë të rrënuar plotësisht, dhe si dëshmi të tij kemi vetëm grumbullin e gurëve në formë harkore, me të cilët është e lehtë të kuptohet që janë rrënojat e mureve të shembura.

Në krahun verior të rrethimit të parë (në mes të ballit të veriut), ka qenë pusi i ujit i Sfetigradit, shkaku i dorëzimit të qytetit osmanëve. Ishte i vetmi vend ku ishte një gropë me dhë, dhe me shenja lagështire. Gjithë pjesa tjetër ishte absolutisht e thatë. Frangu, duke folur për pushtimin që i bënë osmanët kalasë së Sfetigradit, shkruan: “Pasi e pushtoi qytetin, Murati e shembi nga themelet”.

Straboni (63 vite para erës sonë – 20 pas erës sonë) shkruan (Gjeografia, libri VII, 7, 4): Rruga Egnatia “kalon nga Kandavia, mal i Ilirisë, dhe shkon përmes qytetit Lyhniid dhe vendit të quajtur Pylon, që shënon kufirin midis Ilirisë dhe Maqedonisë mbi këtë rrugë. Prej kësaj shkon afër Barnusit përmes Heraklesë, lynkestëve dhe eordejve për në Edesë dhe Pela gjer në Selanik” (Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, vëllimi I, f. 158). Përgatitësit e librit (Frano Prendi, Hasan Ceka, Selim Islami, Skënder Anamali), sqarojnë që Pylon ishte “qendër e fortifikuar në Iliri” (f. 573). Nuk është nevoja të bëjmë sqarime, që qendra e fortifikuar Pylon (e kohës së antikitetit), që ishte në lindje të Ohrit, në kufirin midis Ilirisë dhe Maqedonisë mbi rrugën Egnatia (pa arritur në Manastir), ishte pikërisht ajo Fortifikatë, që me dyndjen e sllavëve në Ballkan, mori emrin Sfetigrad. Duke i parë me kujdes të dhënat historike, të shtrira në terrenin fizik, kufiri Shqipëri – Maqedoni ka qenë në të njëjtin vend që nga antikiteti e deri në mesjetën e vonë, në Pylon, në Sfetigrad, në kreshtën e Peristerit (sot Davat).



Kosova për herë të parë u përfaqësua në Lojërat Olimpikë Rio 2016 me Majlindën dhe për herë të parë ajo ia solli Kosovës medaljen e parë të artë. Falë përkushtimit të saj flamuri i Republikës së Kosovës valoi për herë të parë në këto lojëra. Ajo është e para që i dha jehonë vendit tonë të vogël, shtetit që dominohet nga bashkëmoshatarët e saj të rinj. Kjo forcë e pathyeshme me suksese të njëpasnjëshme ishte dhe do të vazhdojë të mbesë frymëzim për vajzat e Kosovës e përtej Kosovës.



Fjala e Presidentes në aktivitetin e veçantë në nderim të Kampiones tonë, Majlinda Kelmendi

Vjosa Osmani: Me përulësi të them, faleminderit Majlindë!

Ajo me të drejtë cilësohet si legjendë e sportit të xhudos. Ajo me të drejtë konsiderohet heroinë e Kosovës. Me tri dekadat e jetës së saj, Majlinda u bë fytyra e Kosovës së sotme, që e bëri shtetin tonë të tillë çfarë e duam. Flamuri kaltër-verdhë valoi majave krahas flamujve të shteteve më të mëdha anekënd globit, falë triumfit të Majlindës. Ajo na mbajti në ethe, na bëri të qajmë nga gëzimi, na bëri nder e krenari.

Tridhjetë vjeçarja është heroina dhe krenaria e gjithë vendit tonë. Ajo nuk është vetëm xhudiste e njohur botërisht, nuk është vetëm kampione botërore me dy tituj nga kampionatet botërore, nuk është vetëm xhudiste me katër tituj europianë dhe një medalje të artë olimpikë, nuk është vetëm fituese në Grand Slam, Grand Prix e Masters.

Ajo në fakt ka sfiduar sportin e xhudos me çdo gjë që mund të fitohet dhe ka fituar çdo gjë që mund të fitohet!

Majlinda është ëndrra jonë e realizuar, është vërtetë heroina jonë!

Kosova për herë të parë u përfaqësua në Lojërat Olimpikë Rio 2016 me Majlindën dhe për herë të parë ajo ia solli Kosovës medaljen e parë të artë. Falë përkushtimit të saj flamuri i Republikës së Kosovës valoi për herë të parë në këto lojëra. Ajo është e para që i dha jehonë vendit tonë të vogël, shtetit që dominohet nga bashkëmoshatarët e saj të rinj. Kjo forcë e pathyeshme me suksese të njëpasnjëshme ishte dhe do të vazhdojë të mbesë frymëzim për vajzat e Kosovës e përtej Kosovës.

Kjo është Majlinda Kelmendi! Shumë më shumë se sa çmimet që i fitoi.

Pa Majlindën dhe guximin e saj për pushtimin e horizonteve të reja, pa modelin që ajo ua dha të rinjve tanë, sot nuk do ta kishim as Distrian e Norën, e shumë vajza të tjera.

Njeriu më i shpejtë në botë, Eric Liddle, i cili njihet si "skocezi fluturues", thotë se njësoj ka lavdi si në pluhurin e disfatës ashtu edhe në dafinat e fitores, nëse e ke dhënë më të mirën prej vetes! Majlinda e ka dhënë më të mirën e përtej së mirës, ka shndërruar duke e vendosur Kosovën në hartën botërore të xhudos me shpirtin e saj luftarak, disiplinën, përkushtimin e pamasë dhe dashurinë ndaj vendit të saj dhe njerëzve të saj.

Një vajzë e vogël me shpirt të madh tashmë nuk është vetëm histori, ajo është simbol i kurajës, është motiv e shpresë që ka thyer çdo



stereotip, cilado qofshin ato. Triumfi i saj, dëshmoi se nuk ka shtete të vogla që s'mund të ngadhënjëjnë në sportin e xhudos, siç nuk ka vajza që s'mund të triumfojnë në këtë sport. Majlinda i bëri që të dyja. Tregoi fuqinë e

një vajze, sikurse edhe fuqinë e një shteti, për të cilën gjë do t'i jemi falënderues përherë!

Ëndrrën e nisur që prej moshës 8 vjeçe, kur nisi rrugëtimin në sportin e xhudos, ajo e përmbushi me këmbën-

gulje. E përfaqësoi shtetin denjësisht, ishte stoike, luftoi dhe fitoi.

Ajo nuk u josh nga ofertat e shumta të majme për veshjen e fanelës së ndonjë shtetit tjetër, por vendosi t'i qëndrojë besnikërisht ngjyrave të shtetit të saj, Republikës së Kosovës.

Në timonin e trajnerit Driton Kuka, Majlinda dëshmoi se vajzat e Kosovës munden dhe atë në një sport, i cili tradicionalisht konsiderohej si i djemve.

Natyrisht, ky, një sukses i jashtëzakonshëm nën udhëheqjen e një trajneri profesional, kërkues dhe vizionar siç është Toni Kuka, por edhe një drejtuesi të Federatës së Xhudos, si Agron Kuka.

Toni është njeriu meritor, i cili ka bërë që ta ngjallë pasionin për xhudon jo vetëm tek Majlinda, por edhe shumë vajzave e djemve të tjerë, duke e shndërruar Kosovën në konkurrentin kryesor të Japonisë, vendit ku ka lindur sporti i xhudos. Prandaj, Toni dhe Agron, faleminderit që na keni mrekulluar si shtet, na keni lartësuar dhe na keni bërë krenar krahas shteteve më të fuqishme në këtë disiplinë sportive.

Por, sikurse edhe në procesin e pavarësisë së vendit, edhe në xhudo Kosova nuk do të mund t'i arrinte sukseset pa mbështetjen e miqve të shumtë brenda dhe jashtë vendit. Njeriu që bëri shumë për xhudon e Kosovës, pas insistimit të Majlindës, por edhe për Majlindën vet, në veçanti është presidenti i Federatës Botërore të Xhudos, Marius Vizer, ndaj me të drejtë rruga te Qendra Nacionale e Xhudos në Pejë, me vendim të komunës së Pejës mban emrin e tij në shenjë të respektit të përhershëm për atë çfarë ka bërë për vendin tonë. Zoti Vizer, populli i Kosovës do të jetë përherë mirënjohës për mundësinë që ia keni dhënë Majlindës, xhudos dhe shtetit të Kosovës që të shkëlqejë ndërkombëtarisht!

Sot ne jemi këtu për ta hapur një kapitull të ri për Majlindën. Siç la një karrierë të suksesshme në sportin aktiv, Majlinda tash e tutje do ta vazhdojë rrugëtimin e saj në angazhime të tjera në sport, ku besoj fuqishëm sërish ajo do të jetë adresë e patejkalueshme e suksesit.

Asaj i ka hije çfarëdo shpërblimi, sepse ajo e meriton cilindo shpërblim. Asnjëherë ne nuk do të mund t'i dalim hakut për emocionet, për krenarinë për dinjitetin që na e ktheu si shtet. Ajo na trimëroi që si vend i vogël t'i dalim përballë fuqive në sportin e xhudos. Majlinda guxoi për ta bërë ëndrrën e saj dhe të shtetit tonë realitet. Ndaj, si guximtare, këtë kapitull jetësor të saj nuk ka se si ta përmbyllë ndryshe, pos edhe me një dekoratë, e cila e mban edhe emrin e një gruaje tjetër po aq guximtare të cilën do t'ia dorëzoj sot. Sikurse heroina jonë Shotë Galica në betejat me pushkë, Majlinda në betejat sportive mbajti gjallë frymëzimin për breza të tërë, krenarinë tonë kombëtare, mbrojti dinjitetin tonë dhe valëviti lart flamurin e shtetit të Kosovës.

Prandaj, me përulësi të them, faleminderit Majlindë!

Urdhrin me emrin Shotë Galica, një prej urdhrave më të lartë presidencial, i cili u ndahet personave, të cilët kanë avokuar, kanë bërë vepra trimërie e akte guximi dhe në të njëjtën kohë kanë kontribuar edhe në barazinë gjinore sot mbahet në duart e të madhes Majlinda Kelmendi.

Komandanti i FSK-së, Gjeneralmajor Bashkim Jashari, priti në takim Shefen e Operacioneve Aktuale të NATO-s, znj. Ariella Viehe

Gjatë vizitës së saj zyrtare, shefja e Operacioneve Aktuale të Divizionit Operativ të Shtabit të NATO-s, Ariella Viehe, është pritur në takim nga komandanti i FSK-së, gjeneralmajor Bashkim Jashari.

Gjatë takimit, znj. Ariella Viehe shoqërohej edhe nga Drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT), gjeneral brigade Jörg Rüter.

Me këtë rast, gjeneral Jashari i uroi mirëseardhje asaj, duke i shprehur mirënjohjen e thellë për kontributin e Ekipit të NALT-së në të gjitha arritjet e deritanishme të FSK-së, duke theksuar se bashkëpunimi i ndërsjellë do të thellohet edhe më shumë.

Gjeneral Jashari e njoftoi znj. Viehe për vizionin e tij për zhvillimin dhe avancimin e FSK-së, nga pozita e Komandantit të ri të FSK-së, duke u fokusuar në arritjen e kapaciteteve dhe kapaciteteve ndërvepruese operationale me forcat e



vendeve anëtare të NATO-s.

Ai gjithashtu shprehu vullnetin e tij që Kosova nga vend konsumues i sigurisë, i mundësohet ofrimi i kontributit në operatione të përbashkëta me vendet anëtare dhe partnere të NATO-s, për çka është dëshmuar dhe po dëshmohet suksesshëm edhe në mbështetjen në operacionin aktual humanitar të NATO-s për evakuimin

e refugjatëve afganë.

Gjeneral Jashari po ashtu theksoi se përvoja e tij e gjatë si udhëheqës ushtarak, veçanërisht në detyrën e mëparshme si Inspektor i Përgjithshëm i FSK-së, është shumë e rëndësishme për eliminimin e sfidave dhe rrugën e suksesshme përpara drejt përmbushjes së vizionit të qartë dhe objektivave të tij operationale.

Olaf Scholz dhe platforma e tij për Gjermaninë pa "Merkel"

Tashmë, Gjermania ka një kancelar të ri, i pari pas 16 vitesh qeverisje të Angela Merkelit. Olaf Scholz zyrtarisht mori detyrën dje pasi tre parti – Social Demokratët (SPD), Të Gjelbrit dhe Liberalët (FDP) – formuan të ashtuquajturin koalicionin "semafori".

Marrëveshja e koalicionit e hartuar nga qeveria e re gjermane i jep dritën jeshile reformimit shoqëror. Dokumenti prej 178 faqesh quhet "Guximi për të bërë më shumë përparim", gjersa përshkruan udhërrëfyesin politik të koalicionit për Gjermaninë.

Fokusi kryesor është lufta kundër pandemisë së koronavirusit, duke pasur parasysh se Gjermania ka shënuar një rritje drastike të numrit të të infektuarve në muajt e fundit.

Gjatë shpalljes së marrëveshjes të koalicionit, Olaf Scholz njoftoi krijimin e një shtabi të përhershëm të krizës për koronavirusin, i cili do t'i raportojë qeverisë në baza ditore.

Komiteti do të përbëhet nga politikanë kombëtarë dhe rajonalë, si dhe ekspertë në virologji, epidemiologji, sociologji dhe psikologji. Gjithashtu, vendimi i parë i qeverisë së re është vendosja e vaksinimit të detyrueshëm nga shkurti i vitit të ardhshëm.

"Vaksinimi duhet të bëhet i detyrueshëm në vendet që kujdesen për grupet veçanërisht të cenueshme", -tha Scholz.

Bonuse për profesionistët e kujdesit shëndetësor

Punonjësit e kujdesit shëndetësor dhe punonjësit e shtëpive të pleqve do të marrin shpërblime për punën e tyre të palodhur gjatë pandemisë.

Scholz tha se një miliard euro "në fillim" do të destinohen për këtë qëllim. Edhe qeveria e re synon ta bëjë më tërheqëse punën në këtë fushë duke rritur pagat.

Ndryshimi i klimës

Siç pritej, ndryshimi i klimës është fokusi kryesor dhe qeveria e re dëshiron që të gjitha ligjet e ardhshme të kontrollohen dyfish për ndikimin e tyre në ndryshimet klimatike, gjë që nuk është për t'u habitur duke qenë se të Gjelbrit janë një faktor jashtëzakonisht i rëndësishëm në qeveri.

Energjia e rinovueshme do të inkurajohet duke instaluar pajisje diellore në ndërtesat e reja të zyrave, banesave dhe duke krijuar më shumë ferma me erë, veçanërisht në det.

Objektivat ambicioze janë që deri në vitin 2030, rreth 80 për qind e energjisë elektrike të vijë nga burime të rinovueshme dhe 50 për qind e ngrohjes duhet të jetë neutrale ndaj klimës.

Gjithashtu, qymyri, nëse është e mundur, do të largohet deri në vitin 2030 dhe më në fund do të fillojë numërimi pas për automjetet me djegie karburante.

Pyetja e përjetshme: Emigrantët

Qeveria e re do të ndryshojë edhe ligjet për shtetësinë. Partitë e koalicionit po planifikojnë reforma për ta bërë më të lehtë marrjen e nënshtetësisë gjermane. Natyralizimi është i mundur pas pesë vitesh, ose pas tre vitesh nëse aplikantët janë dalluar në aspektin e integritit.

Fëmijët e lindur në Gjermani nga prindër që nuk janë shtetas gjermanë do t'u jepet automatikisht shtetësia nëse njëri prej prindërve ka banuar në vend për të paktën pesë vjet.

Sipas marrëveshjes së koalicionit,



migrimi duhet të jetë "i parashikueshëm dhe realist", ndërsa "migrimi i parregullt" duhet të reduktohet.

Koalicioni synon gjithashtu të zvogëlojë barrën mbi Zyrën Federale për Migracionin dhe Refugjatët. Vizat do të zgjidhen në mënyrë digjitale dhe më shpejt gjersa ka plane për heqjen e ndalimeve aktuale të punësimit "për njerëzit që tashmë jetojnë në Gjermani".

Digjitalizimi: Hiq burokracinë

Koalicioni synon ta bëjë Gjermaninë gati për një të ardhme digjitale dhe të heqë pengesat burokratike aktuale. Të tre partitë duan të fillojnë reformimin e strukturave administrative.

SPD, të Gjelbrit dhe FDP e shohin digjitalizimin dhe transparencën në sektorin publik si një mënyrë për ta arritur këtë. Qëllimi i tyre është të përshejtojnë proceset e miratimit, veçanërisht kur bëhet fjalë për projektet e infrastrukturës.

Përfitimet sociale: Të ardhurat e qytetarëve, jo Hartz IV

Koalicioni i ri kërkon të zëvendësojë skemën e pagesës së papunësisë të njohur si Hartz IV, me atë që ata i quajnë të ardhurat e qytetarëve.

Në vitin 2022 do të rritet në 449 euro në muaj për një person – një rritje prej 3 euro.

Pensionet mbeten të pandryshuara

Koalicioni i ri ka pranuar të mbajë moshën e pensionimit në 67 vjeç. Pensionet nuk duhet të bien nën 48 për qind të nivelit të të ardhurave mesatare aktuale.

Në katër vitet e ardhshme kontributet për pension do të mbeten të ngrira në masën 20 për qind.

Mbrojtja: Dronë të armatosur për ushtrinë

Sipas planeve të koalicionit të ri, forcat e armatosura gjermane do të mund të armatosin dronët e tyre në të ardhmen, me kusht që të ketë transparencë dhe konsideratë të aspekteve të sigurisë dhe etikës.

"Dronët e armatosur mund të kontribuojnë në mbrojtjen e anëtarëve të forcave të armatosura në misionet ndërkombëtare", -shkruan në mar-

rëveshjen tre palëshe.

Moratoriumi i borxhit mbetet pezull
Moratoriumi i borxhit të ri mbetet në pritje deri në vitin 2023, ekonomia ka ende nevojë për ndihmë për të kapërcyer pandeminë. Do të duhet të sigurohen miliarda të tjera për të luftuar ndryshimet klimatike dhe për të kaluar në energjinë e rinovueshme.

Infrastruktura: Zgjerimi i hekurudhave dhe lëvizshmëria elektronike

Të Gjelbrit kërkuar një kufizim të shpejtësisë në të gjitha autostradat ndërshtetërore gjermane, por kjo nuk u përfshi

në marrëveshjen përfundimtare.

Në vend të kësaj, qëllimi është që të ketë të paktën 15 milionë vetura elektrike në rrugët gjermane deri në vitin 2030, me një zgjerim përkatës të infrastrukturës së stacioneve të karikimit.

Transporti hekurudhor gjithashtu duhet të luajë një rol të rëndësishëm. Për shembull, më shumë mallra duhet të zhvendosen nga rruga në hekurudhë. Trafiku hekurudhor i mallrave duhet të rritet me një të katërtën në krahasim me nivelet aktuale.

Qëllimi i koalicionit – të forcojë rolin e Gjermanisë si vend eksportues, ndërkohë që industria duhet të jetë neutrale ndaj klimës.

Qindra mijëra shtëpi të reja

Në zonat e dendura me banesa, qiratë duhet të rriten me vetëm 11 për qind në tre vite. Deri më tani, rritjet prej 15 për qind kanë qenë të mundshme. Rreth 400 mijë apartamente të reja duhet të ndërtohen në vit, nga të cilat 100 mijë do të ndërtohen me fonde publike.

Arsimi: Transformimi Digjital i Shkollave

Ekziston një konsensus midis të gjitha partive politike gjermane se arsimi është një investim kyç në të ardhmen.

Marrëveshja e koalicionit thotë se Gjermania dëshiron t'u ofrojë të gjithëve mundësitë më të mira për arsim, pavarësisht origjinës, për të mundësuar dhe siguruar pjesëmarrjen dhe lëvizshmërinë sociale përmes arsimit gjithëpërfshirës.

Këto tri parti synojnë të mbështesin shkollat veçanërisht në zonat e pa favorizuara sociale.

Modernizimi i sistemit shkollor me ndihmën e teknologjisë së re digjitale është në krye të këtyre ambicieve. Qëllimi është krijimi i një "mjedisi modern të të mësuarit dhe laboratorëve krijues".

Ligji zgjedhor: Më shumë pushtet për të rinjtë

Demonstratat e "E Premtja për të Ardhmen" treguan se të rinjtë duan dhe dinë të përfshihen në politikë. Marrëveshja e koalicionit kërkon ta marrë këtë parasysh duke ulur moshën e votimit nga 18 në 16 vjeç.

Megjithatë, kjo do të kërkonte një ndryshim në kushtetutën gjermane, kështu që do të duhej mbështetja e disa prej partive opozitare.

Bomgartner: Franca dëshiron që bisedimet për anëtarësim të fillojnë pa vonesë, sepse Maqedonia ka bërë përparim të madh dhe e meriton atë

Ambasadori i Francës në Maqedoninë e Veriut, Cyril Bomgartner, deklaroi se Presidenti i Francës tashmë ka thënë se dëshiron që negociatat për anëtarësim të Republikës së Maqedonisë të fillojnë së shpejti.

Ambasadori me këtë rast iu referua deklaratës së presidentit francez Macron, të bërë gjatë vizitës së kryeministrit Zaev në Francë.

"Kryeministri Zaev vizitoi Parisin qershorin e kaluar, ku realizoi një takim historik me Presidentin e Francës. I bëj thirrje të gjithëve që të dëgjojnë edhe një herë deklaratat e bëra për publikun me atë rast. Presidenti i Francës tha dhe përsëriste vazhdimisht se Franca dëshiron që bisedimet për anëtarësim të fillojnë pa vonesë, sepse Maqedonia ka bërë përparim të madh dhe e meriton atë", -tha ambasadori Bomgartner.



10 marinat më të fuqishme në botë

Gazeta "Ushtria
do të botojë në
numrat e ardhshme
marinat më të
fuqishme në botë

Marina kombëtare Franceze është një nga forcat detare më të vjetra në botë. Aktualisht ajo ka rreth 36 000 personel.

Marina franceze operon me një aeroplanmbajtëse të vetme "Charles de Gaulle", e cila është flamurtari i marinës franceze. Është i vetmi aeroplanmbajtës me energji bërthamore, i ndërtuar jashtë Shteteve të Bashkuara, megjithatë është shumë më i vogël se transportuesit amerikanë. Ishte planifikuar edhe një aeroplanmbajtëse e dytë, e ngjashme me atë britanike, të klasit "Mbretëresha Elizabeth", por këto plane u braktisën përfundimisht.

Ka 2 shkatërrues modernë antiajror të klasit "Horizon". Këto anije luftarake që udhetojnë në oqean janë referuar zyrtarisht si fregata. Megjithatë, duke marrë parasysh madhësinë e tyre dhe armatimin e fuqishëm, këto anije janë qartësisht shkatërruese. Këto quhen fregata thjesht për arsye politike. Gjithashtu ka 2 shkatërrues më të vjetër të klasit "Cassard" dhe 4 shkatërrues të klasit "Georges Leygues", që duhet të dalin jashtë përdorimi së shpejti.

Marina franceze operon 4 fregata për drejtimin e raketave të klasit "Aquitaine", ndërkohë që shumë anije të këtij klasi po ndërtohen aktualisht. Këto fregata të reja së shpejti do të zëvendësojnë shkatërruesit e klasit "Cassard" dhe "Georges Leygues" dhe do të zëvendësohen nga fregatat e klasit "Aquitaine". Ka 5 fregata më të vogla të klasit "La Fayette" dhe 6 fregata të klasit "Floreale".

Marina franceze operon 3 anije sulmuese amfibe të klasit "Mistral". Këto janë luftanijet më të



Marina franceze

mëdha pas aeroplanmbajtëses "Charles de Gaulle". Misioni kryesor për këto anije janë operacionet e uljes amfibe. Ato sigurojnë gjithashtu aftësinë e komandës dhe projeksionit të forcës. Marina franceze përfshin një brigadë këmbësorie detare, e cila përbëhet nga rreth 8 000 njerëz. Këto janë forca

ekspeditash, që mund të zbarkohen në brigjet armiqësore dhe të kryejnë bastisje të blinduara deri në 100 km në territorin e armikut.

Marina franceze disponon edhe 4 nëndetëse sulmi të klasit "Rubis" dhe 2 të klasit "Amethyste". Këto janë anijet më të vogla sulmuese me

energji bërthamore. Aktualisht në Francë po ndërtohen nëndetëset e reja sulmuese me energji bërthamore të klasit "Suffren" për të zëvendësuar anijet aktuale.

Marina franceze operon 4 nëndetëse me raketa balistike të klasit "Le Triomphant", që sigurojnë shtyllën kurrizore të parandalimit bërthamor

francez. Aviacioni detar francez ka rreth 210 avionë, duke përfshirë avionë me bazë tokësore dhe transportuese. Këto përfshijnë avionë luftarakë shumë-funksionalë "Rafale" të detarizuar, avionë të paralajmërimit të hershëm të transportuesit "E-2C Hawkeye" dhe aeroplan patrullimi detar "Atlantique II".



Femra, arkitektja e vërtetë e jetës

“Feminizëm nuk do të thotë që gratë të bëhen më të forta. Gratë ashtu janë, të forta. Puna është të ndryshojmë mënyrën se si bota e percepton atë forcë”



Shumë gra, në mënyrë të veçantë ato që janë rritur në vitet ‘50 apo ‘60, nuk e kanë pasur kurrë mundësinë të bëhen pjesë e sporteve apo konkurseve. Vetëm disa prej tyre kanë shërbyer në forcat e armatosura, në akademi ushtarake apo në ndonjë aktivitet të ngjashëm, ku merrnim pjesë në gara modeste. Ishin shumë pak vendet ku mund të luaje dhe të fitoje. Si përfundim, ne nuk dimë të luajmë dhe për këtë arsye, edhe kur luajmë bukur pa i kaluar caqet, deri në sipërfaqe dhe aq. Më keq akoma, shumë gra e perceptojnë lojën në biznes, si diçka të pisët e të pakëndshme që duhet shmangur me çdo kusht.

Sigurisht që nuk më ka shkuar ndonjëherë ndërmend t’u them tërhiquni, por në vend të kësaj, jam përpjekur të flas për rëndësinë e gjërave të thjeshta, siç janë të dëgjuarit, bashkëpunimi, motivimi apo vëmendja ndaj anës njerëzore dhe humane. Këto janë gjëra tipike që gratë i bëjnë shumë mirë, sepse kështu janë mësuar, janë rritur me këtë ide dhe e kanë praktikë konkrete, duke filluar që nga angazhimi në familje. Fushat në të cilat gratë nuk janë aq të afta sa burrat, janë njohuria për kufijtë imagjinarë dhe të kuptuarit e rregullave të pathëna. Shumë prej sugjerimeve, bien ndesh me gjërat që ato kanë mësuar gjatë procesit të tyre të rritjes. Ndeshem shpesh me rezistencën e tyre për të kërkuar gjëra akoma më të vështira. Puna është se nëse nuk luani, nuk fitoni.

Tendenca për të marrë përgjegjësi jo vetëm për punën tuaj, por edhe për atë të të tjerëve mbetet ende një sjellje me të cilën prishni planet tuaja. Dakord, është e vërtetë që keni përgjegjësi përpara punëdhënësit tuaj për të ofruar një produkt apo shërbim me cilësi maksimale, por ama nuk është vetëm përgjegjësia juaj. Gratë kanë një zakon të keq kur thonë: “Po nuk e bëra unë, askush tjetër nuk mundet”. Mos harroni se kjo shndërrohet në një garanci që ju do ta bëni, madje për një kohë të gjatë. Ka një problem tjetër që lidhet ngushtë me marrjen e shumë përgjegjësive dhe me përpjekjen e grave për të punuar me mish e me shpirt dhe ndërkohë që ato bëjnë punën, burrat ndërtojnë karrierën. Promovimet shpesh janë një mënyrë për ta fituar punën, por jo domosdo për ta bërë atë. Në realitetin tim kam njohur dy kategori njerëzish: karrieristët dhe ata që realisht bëjnë punën. Këta të fundit janë gjithnjë të zënë me punë, ndërkohë karrieristët vetëm shpenzojnë kohën duke menaxhuar karrierën e tyre. Për të ecur përpara, duhet të merrni pak nga të dyja.

Ndryshimi midis të menduarit dhe të punuarit është thelbësor për përcaktimin e sjelljeve vetë-mbrojtëse. Shumica prej nesh kanë nocione të ndryshme rreth asaj çfarë na bën të njohur dhe çfarë nuk na bën. Këto janë quajtur sjellje paragjyquese ngaqë ne besojmë se, nëse nuk i bëjmë ato, do të ndodhë diçka katastrofike. Unë do të

shpërblehem vetëm nëse punoj më shumë se gjithë të tjerët dhe shefi im do të më pushojë nga puna nëse unë i them se çfarë mendoj në të vërtetë, janë shembuj të të menduarit supersticioz. Këto mendime janë ndërtuar shpesh rreth mesazheve që kemi marrë nga prindërit në familje, për sa i përket punës që mund të ketë qenë e përshtatshme për prindërit tanë, por që nuk mund të jetë më e vlefshme për ne. Në mënyrë të ngjashme, sjellje të tilla mund të kenë qenë funksionale në hapat e parë të karrierës sonë, por nuk janë aq të dobishme më vonë. Ajo çfarë bëjmë ne si punëtorë të nivelit fillestar për të fituar respektin dhe vëmendjen, është më tepër e lidhur me detyrën që kemi në dorë sesa me mënyrën se si ekspozojmë sjelljet që lidhen me aftësi të veçanta, sidomos me ato të lidhshpimit.

Kur ju shikoni përreth njerëz të cilët promovohen dhe njihen masivisht, pyesni veten, a janë ata njerëz të cilët bëjnë mrekulli? Gratë ushqehen me krenari për

faktin se ato mund të bëjnë shumë punë me më pak infrastrukturë, arrijnë apo kalojnë kufij të pamundur, dhe pranojnë t’i “shtrydhin” deri në fund, pa kërkuar asgjë në këmbim të kohës shtesë. Ato në të vërtetë besojnë se të tjerët do t’i njohin dhe vlerësojnë përpjekjet e tyre. Ja, për kaq lodhen. Çfarë ato nuk kuptojnë është se çdo herë që bëjnë një “mrekulli”, pra bëjnë të pamundurën të mundur, ato kanë shtuar nivelin e pritshmërisë së të tjerëve ndaj tyre. Jo vetëm kaq, por ndërsa ato janë të zëna duke kërcyer nëpërmjet rrathëve të të njëjtit sektor apo departament, kolegët e tyre meshkuj janë duke bërë gjëra që i sjellin më në vëmendje të drejtuesve, më përballë tyre dhe për rrjedhojë, janë fitues të shumë më tepër shpërblimeve.

E keni vënë re që burrat nuk kërkojnë leje? Ata kërkojnë falje. Ajo që për mua është e mundimshme është fakti se gratë kërkojnë shumë më tepër leje se sa është e nevojshme, që dikush t’u japë dritë jeshile për diçka. Duket sikur kjo formë për të pyetur më parë, është garanci për të luajtur në mënyrë të sigurt, por në fakt më tepër se sa kaq, është mbrojtje ndaj

vetes. Në shoqërinë tonë, presim që të na kërkojnë leje fëmijët, jo të rriturit. Sa herë që një grua kërkon leje për të bërë apo për të thënë diçka, zvogëlon staturën dhe e çon veten në pozitë të një fëmije. Gjithashtu e projekton veten për të marrë në shumicën e rasteve një “Jo”. Të kërkojë leje përpara se të veprosh për diçka, ka të ngjarë t’ju perceptojnë se po bëni ndonjë gabim dhe më keq akoma, të shiheni si persona që nuk mund t’u japësh besim për të marrë përsipër risqe. Gratë kërkojnë leje për gjëra nga më të thjeshtat, si për shembull për të marrë një ditë pushim.

Ndonëse gratë e konsiderojnë si problem periferik, ato i përdorin fjalët e vogla shumë më tepër se shumica e burrave. Këto lloj fjalësh janë ato që zvogëlojnë apo i japin rëndësi një arritjeje. E njëjta gjë vlen edhe për vendin e punës. Gratë, nëse kanë arritur suksese, kanë attribute, reagojnë ndaj urimeve dhe komplimenteve me fjali të tilla si: “Nuk ishte asgjë”, “Unë jam thjesht me fat”. Mos provoni t’i thoni shpesh këto lloj frazash, sepse shumë shpejt do të filloni t’i besoni edhe vetë.

Nuk e vë në dyshim që diskriminimi është pjesë reale e eksperiencës së punës në jetën e një gruaje, por përveç rasteve kur ai është aq i dukshëm dhe gruaja nuk ka mundësi të mbrohet, besoj se çdo kompani apo institucion do të bënte ç’të ishte e mundur për të mbrojtur reputacionin, nivelin e menaxhimit dhe gjithë stafin e saj.

Të shprehni si pyetje, diçka që doni të merret si deklaratë, është një nga gabimet më të shpeshta që kam parë të bëjnë gratë. Të bësh një pyetje si mënyra më e sigurt për të shprehur një ide, nuk ju bën të dukeni të drejtpërdrejta. Pyetje që zakonisht marrin formë të tilla si: “Çfarë mendoni nëse ne...?” ose “A keni menduar që...?”, në vend që të merreni me deklaratë të drejtpërdrejta, bëjnë që të heqim dorë nga pronësia mbi idenë tonë dhe rezultatet e saj.

Shpesh here më ndodh të jem pragmatiste dhe jo rrallë herë përpiqem të ngre një zë që gulçon për ty, për ju, për ne, për forcën e brendshme që e mbysim për hir të paragjykimeve.

Të qenurit vajzë, bijë, bashkëshorte, nënë, mike, kolege e rrethuar shpesh prej miklimeve pa adresë, më bën të thërras se: “Ne jemi forca që ndryshojmë botën, ato që i japim eliksirin jetës”.

Grua është një fjalë e madhe, tek ajo është pastërtia e vajzës, vetësakrifica për mikun, heroizmi i nënës.

“Mos investo të prishësh ekuilibrat e natyrës”.

**Kryeredaktore,
Anjeza Musollari**